

Udhëzimet për Kërkuesin e Formularëve W-8BEN, W-8BEN-E, W-8ECI, W-8EXP, dhe W-8IMY (Rishikim, Prill 2018)



Departamenti i Thesarit
Shërbimi i të Hyrave të
Brendshme

Referencat për Nen janë për Kodin e të Hyrave të Brendshme nëse nuk çeket ndryshe.

Zhvillimet në të ardhmen. Për informatat e fundit rreth zhvillimeve që lidhen me Formularët W-8 dhe udhëzimet e tyre, të tilla si legjislacioni i dekretuar pasi të jetë publikuar, shko në [IRS.gov/UAC/About-Form-W8](https://www.irs.gov/uac/about-form-w8).

Çka të re

Më 6 janar 2017, Departamenti i Thesarit dhe IRS=ShHB kanë finalizuar rregullore të caktuara sipas kapitullit 3 (TD 9808) dhe kapitullit 4 (TD 9809) dhe kanë publikuar rregulloret e përkohshme sipas kapitujve 3 dhe 4 për të plotësuar dispozita të caktuara të atyre rregulloreve përfundimtare. Në mesin e gjerave tjera, rregulloret përfundimtare dhe të përkohshme sipas kapitujve 3 dhe 4 kanë ndryshuar kërkesat e caktuara në lidhje me mbledhjen e Formularëve W-8, përmbajtës së formularëve, periudhat e tyre të vlefshmërisë, si dhe kërkesat e kujdesit të duhur për agjentët e mbajtjes në burim. Formularët W-8 (dhe udhëzimet e tyre) janë freskuar në Qershor dhe Korrik 2017, në përgjithësi, për të reflektuar amendamentet në rregullore sipas kapitujve 3 dhe 4.

Më 24 janar 2017, Departamenti i Thesarit dhe IRS kam finalizuar rregullore të caktuara sipas neneve 871(m) dhe 1441 (TD 9815) dhe ka publikuar rregulloret e përkohshme sipas nenit 871 (m) për të plotësuar dispozita të caktuara të atyre rregulloreve përfundimtare. Në mesin e gjerave tjera, rregulloret përfundimtare dhe të përkohshme sipas neneve 871(m) dhe 1441 kanë ndryshuar rregullat për mbajtje në burim dhe raportim të pagesave të caktuara të kryera për dilerë të kualifikuar derivativ (qualified derivative dealers=QDD).

Departamenti i Thesarit dhe IRS po ashtu kanë lëshuar [Notice 2017-42](https://www.irs.gov/notice/2017-42), 2017-34 I.R.B. 212, e cila ka shpallur amendamente të caktuara për të ardhmen për rregulloret, të tilla si shtyrja e mbajtjes në burim deri në vitin 2019 sipas kapitujve 3 dhe 4 në dividendë të paguar për një QDD në ekuitetin e vetë kapacitetit të dilerëve derivativ.

Rregullat e tranzicionit që lidhen me regjimin e Huadhënësit të Kualifikuar të Letrave me Vlerë - Qualified Securities Lender (QSL) të përshkruara në [Notice 2010-46](https://www.irs.gov/notice/2010-46), 2010-24 I.R.B. 757, janë zgjeruar për të përfshirë pagesat e kryera në vitet kalendarike 2018 dhe 2019. Shih [Notice 2018-05](https://www.irs.gov/notice/2018-05), 2018-6 I.R.B. 341. Kështu, agjentët e mbajtjes në burim mund të pranojnë dhe të mbështeten në Formularin e vlefshëm W-8IMY në të cilin

një entitet paraqet statusin e vet sipas kapitullit 3 si QSL deri më 31 dhjetor 2019.

Përveç kësaj, më 25 shtator 2017, Departamenti i Thesarit dhe IRS kanë lëshuar [Notice 2017-46](https://www.irs.gov/notice/2017-46), 2017-41 I.R.B. 275, duke ofruar udhëzuesin e ndryshuar për agjentë të caktuar të mbajtjes në burim për të siguruar dhe raportuar numrat identifikues të tatimpaguesit dhe datat e lindjes të mbajtësve të llogarive të tyre dhe më 5 mars 2018 Departamenti i Thesarit dhe IRS kanë lëshuar udhëzuesin plotësues në [Notice 2018-20](https://www.irs.gov/notice/2018-20), 2018-12 I.R.B. 444. Shih [TIN-ët e Huaj](https://www.irs.gov/notice/2018-20) dhe më vonë [Shënimet për Verifikimin e Formularit W-8BEN-E](https://www.irs.gov/notice/2018-20), për kërkesat e ndryshuara për agjentë të caktuar të mbajtjes në burim për të siguruar në Formularin W-8 TIN-in e huaj të mbajtësit të llogarisë dhe për një individ datën e lindjes.

Qëllimi i udhëzimeve

Këto udhëzime plotësojnë udhëzimet për formularët e listuar më poshtë dhe për të ofruar shënime që ndihmojnë agjentët e mbajtjes në burim dhe institucionet e huaja financiare (FFI) në validimin e formularëve për qëllime të kapitujve 3 dhe 4. Këto udhëzime po ashtu përvijojnë kërkesat e kujdesit të duhur që aplikohet të agjentët mbajtës në burim për të vendosur statusin e pronarit përfitues të huaj dhe për të kërkuar uljen e mbajtjes në burim sipas një traktati të tatimit në të ardhura. Këto udhëzime nuk përfshijnë të gjitha kërkesat që mund të aplikohen te një agjent i mbajtjes në burim për të verifikuar Formularët W-8. Një agjent i mbajtjes në burim po ashtu duhet t'u referohet rregulloreve të aplikueshme sipas kapitujve 3 dhe 4 dhe udhëzimeve për secilin Formular W-8 të paraqitur më poshtë.

- Formulari W-8BEN, Certifikata e Statusit të Huaj të Pronarit Përfitues për Mbajtje në Burim të Tatimit dhe Raportimit për Shtetet e Bashkuara (Individët).
- Formulari W-8BEN-E, Certifikata e Statusit të Huaj të Pronarit Përfitues për Mbajtje në Burim të Tatimit dhe Raportimit për Shtetet e Bashkuara (Entitetet)
- Formulari W-8ECI, Certifikata e Kërkesës së Personit të Huaj që të Ardhurat janë të Lidhura në Mënyrë Efektive me Kryerjen e Tregtisë apo Biznesit në Shtetet e Bashkuara.
- Formulari W-8EXP, Certifikata e Qeverisë së Huaj apo Organizatave tjera të Huaja për Mbajtje në Burim të Tatimit dhe Raportimit për Shtetet e Bashkuara.
- Formulari W-8IMY, Certifikata e Ndërmjetësit të Huaj, Entitetit Rrjedhës Të Huaj, apo Degë të caktuara të ShBA-së për Mbajtjen në Burim të Tatimit dhe Raportimit për Shtetet e Bashkuara.

Për përkufizimet dhe termat e pa përkufizuar në këto udhëzime, shih Formularët W-8 dhe udhëzimet e tyre shoqëruese.



Gjatë këtyre udhëzimeve, referimi apo përmendja e "Formulari W-8" përfshinë Formularët W-8BEN, W-8BEN-E, W-8ECI, W-8EXP, dhe W-8IMY.

Këto udhëzime pasqyrojnë ndryshimet rregullative të përshkruara më herët që lidhen me Formularët W-8 dhe ndryshime tjera të caktuara të pasqyruara në shumicën e ndryshimeve të tanishme në serinë e Formularit W-8 të publikuar që nga data e publikimit të këtyre udhëzimeve. Kështu rregulla të ndryshme mund të aplikohen te agjentët e mbajtjes në burim në lidhje me ndryshimet e mëhershme të Formularëve W-8 për të cilat këto ndryshime rregullative nuk janë aplikuar ende, dhe kërkesa tjera mund të aplikohen për ndryshimet në të ardhmen në këta formularë. Shih më tutje [Kërkimi i Versioneve të përparshme të Formularëve W-8](#), duke përfshirë kufizimet në përdorimin e tillë.

Kush është Agjenti i Mbajtjes në Burim?

Çdo person, i ShBA-së apo i huaj, që vepron në çfarëdo kapaciteti, i cili ka kontroll, pranon, dëftesë, kujdestari apo pagesë të një shume që i nënshtrohet mbajtjes në burim për qëllime të kapitullit 3 apo pagesë të mbajtshme në burim për qëllime të kapitullit 4 është agjent i mbajtjes në burim. Agjenti i mbajtjes në burim mund të jetë një individ, korporatë, ortakëri, trust, asociacion, apo entitet tjetër, duke përfshirë (por duke mos u kufizuar) çdo ndërmjetës të huaj, ortakëri të huaj, apo degë të ShBA-së të bankave dhe kompanive të sigurimeve të caktuara të huaja. Nëse disa persona kualifikohen si agjentë të mbajtjes në burim për një pagesë të vetme, tatimi që duhet të mbahet në burim duhet të mbahet vetëm një herë. Në përgjithësi, personi i cili paguan (apo shkakton pagesën) një shumë që i nënshtrohet mbajtjes në burim sipas kapitullit 3 apo një pagesë të mbajtshme në burim për personin e huaj (apo agjentin e tij) duhet të mbaj në burim. Shih Udhëzimet për Formularin 1042, Deklarata Tatimore Vjetore e Mbajtjes në Burim për Të Ardhurat e Burim të ShBA-së për Personat e Huaj, dhe Formulari 1042-S, Të Ardhurat me Burim të ShBA-së të Personave të Huaj që i Nënshtrohen Mbajtjes në Burim, për obligimin në dorëzimin e deklaratës dhe raportimin e informatave në lidhje me pagesat e kryera për personat e huaj.

Për të ardhurat e tatueshme që lidhen në mënyrë efektive - effectively connected taxable income (ECTI) e që i alokohen një partneri (ortaku) të huaj, ortakëria është në përgjithësi agjent i mbajtjes në burim dhe duhet të dorëzojë Formularin 8804, Deklarata Vjetore për Tatimin e Mbajtur në Burim të Ortakërisë (Neni 1446); Formulari 8805, Pasqyrë Informatash për Ortakun e Huaj të Nenit 1446 Mbajtja në Burim e Tatimit; dhe Formulari 8813, Vauçeri i Pagesës së Tatimit të Mbajtur në Burim nga Ortakëria (Neni 1446).

Përgjegjësitë e Agjentit të Mbajtjes në burim për të siguruar Formularin W-8

Përgjegjësitë e Kapitullit 3 (Ndryshe nga neni 1446)

Në përgjithësi, një shumë që i nënshtrohet kapitullit 3 të mbajtjes në burim është një shumë nga burime përbrenda ShBA-së që është e ardhur fikse apo e përcaktueshme në mënyrë vjetore apo periodike (fixed or determinable annual or periodical -FDAP). Të ardhurat FDAP janë të gjitha të ardhurat e përfshira në të ardhurat bruto, duke përfshirë interesin (si dhe OID), dividendët, qiratë, të drejtat pronësore dhe kompensimin. Të ardhurat FDAP nuk përfshijnë shumicën e fitimeve nga shitja e pasurisë (duke përfshirë zbritjen tregtare dhe primet opsionale), apo zëra të të ardhurave të përjashtuara nga të ardhurat bruto pavarësisht statusit të ShBA-së apo të huaj të pronarit të të ardhurave, të tilla si interesi sipas nenit 103(a). Shumat që i nënshtrohen mbajtjes në burim të kapitullit 3 nuk përfshijnë të ardhura që nuk janë FDAP si dhe zëra tjerë specifik të të ardhurave të përshkruara në nenin 1.1441-2 të Rregulloreve (interes të tillë si depozitat bankare dhe OID afat-shkurta).

Për qëllime të neneve 1441 dhe 1442, nëse jeni agjent i mbajtjes në burim, duhet të mbani në burim 30% në çdo pagesë të një shume që i nënshtrohet mbajtjes në burim të kapitullit 3 të bërë për pagesë-pranuesin (të paguarin) që është person i huaj nëse mundeni në mënyrë të besueshme ta mbështesni pagesën me dokumentacion (për shembull, Formulari W-8 apo Formulari W-9, Kërkesa për Numër Identifikues i Tatimpaguesit dhe Certifikimi) mbi të cilën mund të mbështeteni të trajtoni pagesën të bërë për (a) një i paguar që është një person i ShBA-së apo (b) një pronar përfitues që është një person i huaj me të drejtë për një shkallë të reduktuar, apo lirim, nga mbajtja në burim. Megjithatë në rrethana të caktuara, mund të lejoheni ta shoqëroni pagesën me evidenca dokumentuese në vend të Formularit W-8 për një pagesë të bërë jashtë ShBA-së në lidhje me obligimin offshore sipas nenit 1.6049-5(c)(1) të Rregulloreve. Agjenti i mbajtjes në burim duhet po ashtu të mbajë në burim sipas nenit 1443 në pagesa të caktuara për organizata të huaja që janë të liruara nga tatimi të cilat janë të ardhura të tatueshme që nuk lidhen me biznes apo i nënshtrohen akcizës tatimore 4% të vendosur nga neni 4948.

Sidoqoftë, një agjent i mbajtës në burim që kryen pagesë për një person të huaj nuk ka nevojë të mbajë në burim sipas kapitullit 3 nëse personi i huaj merr përgjegjësinë për mbajtje në burim në pagesë si ndërmjetës i kualifikuar (qualified intermediary-QI) (ndryshe nga një ndërmjetës i kualifikuar që vepron si QDD për pagesat që lidhen me letrat themelore me vlerë që i nënshtrohen mbajtjes në burim), apo nëse personi i huaj është një ortakëri e huaj e mbajtjes në burim, apo trust i huaj i mbajtjes në burim e cila ka dhënë Formularin W-8IMY të vlefshëm duke certifikuar statusin e tillë. Për vitin 2017 dhe 2018, megjithatë, agjenti i mbajtjes në burim nuk kërkohet të mbajë në burim në dividendë të paguara për një ndërmjetës të kualifikuar që vepron si QDD. Po

ashtu sipas kapitullit 3 nuk kërkohet mbajtja në burim nëse pagesa është bërë për një degë të ShBA-së për një kompani të huaj sigurimesh apo bankë të huaj apo institucion financiar territorial që pajtohet të trajtohet si person i ShBA-së sipas kërkesave të nenit 1.1441-1(b)(2)(iv)(A) të rregulloreve dhe jep Formularin W-8IMY të vlefshëm duke certifikuar statusin e tillë.

Përgjegjësitë e Kapitullit 4

Për qëllime të kapitullit 4, nëse jeni agjent i mbajtjes në burim, duhet të mbani 30% në çdo pagesë që është pagesë për t'u mbajtur në burim (sikurse është përkufizuar në nenin 1.1473-1(a) të Rregulloreve) të kryera për një FFI jo-pjesëmarrëse që nuk është pronar përfutues i përjashtuar apo për një entitet të huaj jo-financiar (non-financial foreign entity - NFFE) që nuk është NFFE e përjashtuar dhe nuk shfaq pronarët e rëndësishëm të ShBA-së (apo certifikon se nuk ka pronar të rëndësishëm të ShBA-së). Përveç kësaj, nëse jeni agjent i mbajtjes në burim dhe po ashtu FFI pjesëmarrëse, duhet të mbani në burim deri në masën e kërkuar me nenin 1.1471-4(b) të rregulloreve dhe me marrëveshjen e FFI, e cila, krahas kërkesave të përshkruara në fjalinë e mëparshme, kërkon mbajtje në burim në pagesa që mbahet në burim që kryhen për mbajtësit e pabindur të llogarive.

Duhet të përcaktoni nëse një pagesë është për mbajtje në burim pavarësisht ndonjë përjashtimi nga mbajtja në burim e aplikueshme sipas kapitullit 3. Për secilën pagesë të tillë për t'u mbajtur në burim, duhet të siguronit Formularin W-8 (apo dokumentacion tjetër i lejuar sipas nenit 1.1471-3(d) të Rregulloreve) mbi të cilat jeni i lejuar të mbështeteni sipas kapitullit 4 për të përcaktuar statusin e kapitullit 4 të të paguarit që është një person i huaj për qëllime nëse mbajtja në burim aplikohet sipas kapitullit 4. Kështu, një përcaktim nëse Formulari W-8 është i vlefshëm për qëllime të ofrimit të përjashtimit nga kapitulli 4 për mbajtje në burim, është një përcaktim i ndarë nga ajo nëse do të mund të mbështetëj në Formulari W-8 për të ofruar përjashtim nga (apo ulje në) mbajtja në burim sipas kapitullit 3. Për qëllime të përcaktimit nëse mbajtja në burim sipas kapitullit 4 mund të aplikohet në një pagesë për një ndërmjetës të kualifikuar, ortakëri e huaj e mbajtjes në burim, apo trust i huaj i mbajtjes në burim, do të aplikohet përjashtimi në kapitullin 3 për ndërmjetës e kualifikuar (QI), ortakëritë e huaja të mbajtjes në burim (WP) dhe trustet e huaja të mbajtjes në burim (WT), me kusht që entiteti të përfshijë statusin e vet sipas kapitullit 4 në Formularin W-8IMY. Shih, më vonë nën Formularin W-8IMY, po ashtu Shënime për Validimin e Formularit W-8IMY, kërkesat për mbajtje në burim në pagesat e bëra për degë të caktuara të ShBA-së që veprojnë si ndërmjetës.

Përgjegjësitë e Nenit 1446

Në përgjithësi, sipas nenit 1446, një ortakëri që alokon ECTI për një ortakëri të huaj duhet të mbaj në burim në shkallën më të lartë tatimore të aplikueshme për atë person për llojin e të ardhurave të alokuara (për shembull, të ardhurat e zakonshme apo fitimet kapitale) në përputhje me neneve 1.1446-1 deri 1.1446-6 të rregulloreve. Përveç nëse ortakëria është një ortakëri

tregtare publike, ortakëria duhet të mbajë në burim në vitin në të cilin është e alokueshme ECTI për ortakun e huaj, në vend të vitit në të cilin është bërë shpërndarja. Ortakëria mund të mbështetet në dokumentacionin (për shembull, Formularin W-8 ose Formularin W-9) për të përcaktuar nëse ortaku është i huaj apo vendor dhe llojin e ortakut (për shembull, individual apo korporatë) dhe nëse ortaku kualifikohet për shkallë të caktuara tatimore preferenciale (për shembull, fitimet kapitale dhe koleksionet).

Dokumentacioni duhet të përmbajë TIN e ShBA-së për ortakun. Në përgjithësi, një person i huaj që është ortak në një ortakëri që dorëzon një Formular W-8 për qëllime të nenit 1441 ose 1442 do të plotësojë kërkesat e dokumentacionit sipas nenit 1446. Megjithatë, një ortakëri që e di ose ka arsye ta dijë se dokumentacioni dorëzuar është i pasaktë apo i pabesueshëm duhet që ortakun ta konsiderojë (supozojë) si të huaj. Krahas kësaj, një ortakëri mund të mbështetet në mënyra tjera për të përcaktuar statusin jo të huaj të një ortakut, por do të mbrohet vetëm nga detyrimi (duke përfshirë ndëshkimet) nëse përcaktimi i tillë është i pasaktë. Një ortakëri në asnjë rast nuk kërkohet të mbështetet në mënyrat e të tjerëve për të përcaktuar statusin jo të huaj të ortakut dhe mund të kërkojë që ortaku të ofrojë një certifikatë të pranueshme (për shembull, një Formular W-8BEN).

Përdorimet tjera të formularit W-8.

Kapitulli 61 dhe neni 3406. Formularin W-8 që keni marrë mundet po ashtu të përdoret për të vendosur statusin e një personi për qëllime të raportimit vendor të informatave sipas kapitullit 61 dhe mbajtjes në burim rezerve sipas nenit 3406, duke përfshirë për një entitet rregullues të pagesave për të përcaktuar nëse i paguari pjesëmarrës është një person i huaj për qëllime të nenit 6050W. Në përgjithësi, nëse merrni një Formular W-8 në të cilin mund ta shoqëroni me besueshmëri me pagesën, ju jeni i liruar nga raportimi i pagesës në një Formular 1099 dhe mbajtje në burim sipas nenit 3406.

Dokumentimi i mbajtësve të llogarive nga FFI. Nëse jeni një FFI që mirëmban llogari financiare, nga ju mund të kërkohet të kryeni procedurat e kujdesit të duhur për të identifikuar dhe dokumentuar mbajtësin e llogarisë sipas rregulloreve të kapitullit 4 apo sipas marrëveshjeve të aplikueshme ndër-qeveritare (IGA) madje edhe nëse nuk kryeni pagesë për mbajtësin e llogarisë që i nënshtrohet mbajtjes në burim. Mund të përdorni Formularin W-8 për të dokumentuar statusin e kapitullit 4 të një mbajtësi të llogarisë dhe për të validuar një kërkesë të statusit të huaj e bërë nga mbajtësi i llogarisë, të tilla kur llogaria ka indikacione të caktuara të ShBA-së. Për shembull, një FFI pjesëmarrëse mund të trajtojë një mbajtës individual të llogarisë që kërkon statusin e huaj e që ka indikacione të ShBA-së (sikurse është përshkruar në nenin 1.1471-4(c)(5)(iv)(B) të Rregulloreve) si person i huaj për qëllime të kërkesave të raportimit të llogarisë së ShBA-së (d.m.th. Formulari 8966) kur individi ofron Formularin W-8BEN dhe evidencë të caktuar dokumentuese për të vendosur statusin e huaj.

Nëse jeni një FFI që dokumenton një mbajtës të llogarisë të një llogarie që keni përcaktuar se përjashtohet si llogari financiare sipas nenit 1.1471-5(b)(2) të

Rregulloreve, nuk kërkohet Formular W-8 (apo dokumentacion tjetër i lejuar për qëllime të kapitullit 4) përveç nëse formulari është shoqëruar me shumat që i nënshtrohen mbajtjes në burim sipas kapitullit 3. Në rast të tillë, nuk kërkohet të ofrohet në formular statusi i vlefshmërisë së kapitullit 4.

Kërkimi i Formularit W-8

Në përgjithësi, nëse kryeni një pagesë të një shume që i nënshtrohet kapitullit 3 të mbajtjes në burim apo pagesë për t'u mbajtur në burim, duhet të mbani në burim siç kërkohet në shkallën 30% sipas kapitullit 3 apo 4, përveç nëse mund të shoqëroni në mënyrë të besueshme pagesën me Formularin W-8 apo dokumentim tjetër të lejueshëm për të lejuar mbajtjen në burim në shkallën e zbritur apo lirimin nga mbajtja në burim. Ju mund ta shoqëroni në mënyrë të besueshme një pagesë me një Formular W-8 nëse mbani një formular të vlefshëm që përmban informatat e kërkuara për qëllime të kapitullit 3 ose 4 (siç aplikohet), ju mund ta përcaktoni në mënyrë të besueshme se sa nga pagesa lidhet me formularin, si dhe mund të mbështeteni në formularin sipas kërkesave të kujdesit të duhur. Shih më tutje [Në përgjithësi Kërkesat për Kujdes të Duhur](#).

Ju duhet të kërkoni një Formular W-8 nga çdo person të cilit i bëni pagesë që besoni se është person i huaj. Formularin duhet ta kërkoni para se të bëhet pagesa ashtu që të keni formularin kur ta bëni pagesën. Megjithatë shih nenet 1.1441-1(b)(7)(ii) dhe 1.1471-3(c)(7)(ii) të Rregulloreve se kur mund të keni mundësinë të mbështeteni në Formularin W-8 të siguruar pas datës së pagesës për të mbështetur zbritjen e mbajtjes në burim për qëllime të kapitullit 3 ose 4.

Një agjent i mbajtjes në burim apo pagues që nuk siguron një Formular W-8 ose Formular W-9 të vlefshëm dhe nuk mban në burim siç kërkohet me rregullat e supozimit mund të vlerësohet tatimi në shkallën 30% sipas kapitullit 3 ose 4, ose 28% të shkallës së mbajtjes në burim rezervë sipas nenit 4306, si dhe interesi dhe ndëshkimet për mungesë të përmbushjes. Nëse jeni ortakëri që i alokon të ardhurat të cilat në mënyrë efektive janë të lidhura me sjelljen e tregtisë apo biznesit të ortakërisë së ShBA-së dhe nuk mbani në burim sikurse kërkohet me nenin 1446, do të keni obligim që tatimi i kërkuar të mbahet në burim. Përveç kësaj, mund të keni obligim edhe për interes, ndëshkime dhe shtesa të tatimit madje edhe nëse nuk ka detyrim të tatimit bazë obligim nga një ortak i huaj në pjesën e tij të alokuarës së ECTI-së së ortakërisë.

Nëse jeni agjent i mbajtjes në burim që kryen pagesë të një shume që i nënshtrohet mbajtjes në burim nga kapitulli 3 apo pagesë për t'u mbajtur në burim dhe kryeni pagesë për një ndërmjetës, atëherë duhet të siguroni dokumentacionin nga ndërmjetësi i tillë (përfshirë statusin sipas kapitullit 4 të ndërmjetësit nëse pagesa është pagesë për t'u mbajtur në burim), si dhe çdo dokument i nevojshëm për pronarin(ët) përfitues të pagesës për aq sa kërkohet me rregulloret e kapitullit 3 ose 4.

Mos i dërgo Formularët W-8 në IRS. Në vend se aty, mbani formularët në regjistrimet tuaja për aq gjatë sa

mund të jenë relevante për të përcaktuar detyrimin tuaj sipas nenit 1461 (për shumat që i nënshtrohen mbajtjes në burim të kapitullit 3), neni 1474 (për pagesa për t'u mbajtur në burim), apo nenin 1.1471-4(c)(2)(iv) të Rregulloreve (për një FFI që dokumenton mbajtësit e llogarive).

Dorëzimi dhe nënshkrimi elektronik i Formularit W-8.

Ju mund të mbështeteni në një Formular W-8 të pranuar nga faksimili apo të skanuar dhe të dorëzuar juve përmes email-it përveç nëse e dini se personi që transmeton Formularin W-8 nuk është i autorizuar të bëjë.

Po ashtu ju mund të mbështeteni në një Formular W-8 të vlefshëm i cili përndryshe është pranuar në mënyrë elektronike nga një depo e palës së tretë nëse formulari është ngarkuar apo siguruar në depo e palës së tretë dhe se janë të vendosura procese për të siguruar se certifikata e mbajtjes në burim mundet në mënyrë të besueshme të shoqërohet me një kërkesë të veçantë nga ju dhe një autorizim i veçantë nga personi që dorëzon formularin (apo një agjent i personit që dorëzon formularin) për ju për të marrë certifikatën e mbajtjes në burim. Ju po ashtu mund të mbështeteni në një deklaratë të mbajtjes në burim të marrë nga depoja e palës së tretë nëse ndërmjetësi ofron një Formular W-8IMY dhe deklaratën e mbajtjes në burim përmes depos, iu dorëzon një deklaratë të freskuar të mbajtjes në burim në rast të ndonjë ndryshimi të informatave të dorëzuara më herët, si dhe siguron se janë të vendosura procese për të ju dhënë të rejtat kur ka deklaratë të re të mbajtjes në burim (dhe Formularët W-8, sipas nevojës) në rast të ndonjë ndryshimi që mund të prek vlefshmërinë e formularëve të mëhershëm apo deklaratës së mbajtjes në burim. Për qëllime të këtij paragrafi, një depo e palës së tretë është një entitet që mirëmban certifikatat e mbajtjes në burim, por nuk është agjent i agjentit të aplikueshëm për mbajtje në burim apo person që dorëzon certifikatën. Shih nenin 1.1441-1(e)(4)(iv) (E) të Rregulloreve për të plotësuar kërkesat për t'u mbështetur në një certifikatë të mbajtjes në burim nga një depo e palës së tretë.

Nëse jeni agjent i mbajtjes në burim që mirëmban një sistem për furnizim në mënyrë elektronike të Formularëve W-8, duhet të plotësoni kërkesat e nenit 1.1441-1(e)(4)(iv) (B) të Rregulloreve. Përndryshe mund të pranoni Formularin W-8 përbrenda nënshkrimit elektronik nëse Formulari W-8 në mënyrë të arsyeshme demonstroi se formulari është nënshkruar në mënyrë elektronike nga një person i autorizuar për ta bërë (për shembull, me kohën dhe datën e stampuar dhe deklaramin se formulari është nënshkruar në mënyrë elektronike). Ju mund të mos e trajtoni Formularin W-8 me emrin e shtypur në linjën e nënshkrimit të nënshkruar në mënyrë të vlefshme pa informata shtesë që mbështesin se nënshkrimi është nënshkrim elektronik.

Kërkimi i versioneve të mëhershme të Formularit W-8

Nëse IRS lëshon një version të freskuar të një Formulari W-8, ju mund pranoni versionin e mëhershëm të formularit deri në gjashtë muaj të plotë të vitit kalendarik kur është lëshuar formulari (bazuar në datën e ndryshimit të treguar në formular), përveç nëse IRS ka lëshuar udhëzim se prek periudhën e pranimit të versionit të

mëparshëm (për shembull, nëse statusi i ri i të paguarit kërkohe sipas rregulloreve të ndryshuara që nuk janë në versionin e mëparshëm dhe janë relevante me kërkesën e të paguarit). Ju jeni të lejuar të pranoni një Formular W-8BEN me datën e ndryshimit të Shkurt 2014 deri 31 Dhjetor 2017.

Kërkesat e Kujdesit të duhur në përgjithësi

Kur të merrni një Formular W-8 të plotësuar, duhet të rishikoni nëse është plotësuar dhe nëse është e saktë në lidhje me kërkesat e bëra në formular, si dhe çdo informatë të bashkangjitur në formular, të tilla si deklaratat e mbajtjes në burim dhe certifikatat e mbajtjes në burim të pronarit përfitues të shoqëruara me një Formular W-8IMY. Në përgjithësi, mund të mbështeteni në informatat dhe certifikatat e ofruara në formular përveç nëse keni njohuri apo arsye të forta të dini se informatat janë të pasigurta apo të pasakta. Nëse e dini apo keni arsye ta dini se ndonjë informatë është e pabesueshme apo e pasaktë, ju duhet të siguroni Formularin W-8 të ri apo dokumentacion tjetër të përshtatshëm. Ju mund të pranoni një Formular W-8 të vlefshëm për qëllime të kapitullit 3 apo 61 (apo për qëllime të mbajtjes në burim rezervë) që nuk përmban status të vlefshëm të kapitullit 4 në lidhje me pagesat që nuk janë pagesa për t'u mbajtur në burim.

Arsyeja për të ditur. Në përgjithësi, ju keni arsye ta dini se Formulari W-8 është i pasigurt dhe i pasaktë nëse:

- Formulari është i pakompletuar në lidhje me çdo pikë që lidhet me kërkesat e bëra;
- Formulari përmban ndonjë informatë që është e papajtueshme me kërkesat e bëra;
- Formularit i mungojnë informatat e nevojshme për të vendosur se pronari përfitues ka të drejtë në shkallën e zbritur të mbajtjes në burim; ose
- Keni informata tjera të llogarisë që janë në mospërputhje me kërkesat e bëra; apo keni njohuri se faktet relevante që përmbahen në certifikatën e mbajtjes në burim apo dokumentacion tjetër që do të shkaktonë në mënyrë të arsyeshme që një person i matur në pozitën tuaj të pyes për kërkesat e bëra. Për shembull, nëse keni informata në regjistrimet tuaja se janë në kundërshtim me informatat e dhëna në formular, ju nuk mund të mbështeteni në formular.

Sa i përket një kerkese për përfitimet sipas një traktati tatimor për të ardhurat, arsyeja juaj për të ditur kërkesën se kërkesa e traktatit është e pasigurt dhe e pasaktë, është atëherë kur pronari përfitues kërkon përfitimet sipas traktati i cili nuk ekziston apo nuk është në fuqi. Për këtë qëllim, mund të përdorni listën e mirëmbajtur në [IRS.gov/businesses/international-businesses/united-states-income-tax-treaties-a-to-z](https://www.irs.gov/businesses/international-businesses/united-states-income-tax-treaties-a-to-z) për të verifikuar nëse ekziston traktati dhe a është në fuqi.

Nëse jeni institucion financiar (ipërkufizuar në nenin 1.1471-5(e) të rregulloreve), kompani sigurimi, apo broker apo diler në letrat me vlerë që mirëmban një llogari për një mbajtës direkt të llogarisë që është pronar përfitues i

pagesës dhe ju kryeni pagesën e të ardhurave FDAP me burim të ShBA-së për një mbajtës direkt të llogarisë, ju keni arsye të dini se një Formular W-8 që është certifikatë e mbajtjes në burim të pronarit përfitues (duke përfshirë Formularin W-8ECI) është i pasigurt apo i pasaktë për të vendosur mbi statusin e huaj (apo rezidencën në një vend me traktat në pikën 4, menjëherë poshtë) vetëm nëse një ose më shumë nga rrethanat vijuese ekzistojnë. Shih po ashtu nenin 1.441-7(b)(3)(ii) të Rregulloreve për rregulla të veçanta që aplikohen për obligimet para-ekzistuese (sikurse është e përkufizuar për qëllime të tilla).

1. Keni klasifikuar mbajtësin e llogarisë i cili kërkon statusin e huaj si person i ShBA-së në informatat tuaja të llogarisë, Formulari W-8 ka adresën e fundit të përhershme të rezidencës apo një adresë të fundit të postës në ShBA, ju keni një rezidencë të fundit apo adresë të fundit të postës në ShBA si pjesë të informatave të llogarisë, mbajtësi direkt i llogarisë ju njofton për rezidencën e re apo adresën e re e postës në ShBA, apo vetëm deri në shkallën e përshkruar në nenin e 1.1441-7(b)(5) të Rregulloreve, keni numrin e telefonit të ShBA-së si numër të vetëm telefoni për mbajtësin e llogarisë. Megjithatë:

a. Një individ i cili ka ofruar një Formular W-8BEN mund të trajtohet si person i huaj nëse:

i. Keni në posedim apo siguroni evidencë dokumentuese që vendos statusin e huaj (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5)(i)) të Rregullores) që nuk përmban adresë të ShBA-së, si dhe individ i ofron sqarim të arsyeshëm, me shkrim, që mbështet pohimin e tij apo saj të statusit të huaj;

ii. Për pagesën e kryer jashtë ShBA-së në lidhje me një obligim offshore (sikurse është përshkruar në Nenin 1.6049-5(c)(1) të Rregullores), keni në posedim apo keni siguruar evidencë dokumentuese që vendos statusin e huaj (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5)(ii)) të Rregullores) që nuk përmban adresë të ShBA-së,

iii. Për pagesën e kryer në lidhje me një obligim offshore (sikurse është përshkruar në Nenin 1.6049-5(c)(1) të Rregullores), e keni klasifikuar individin si rezident të vendit ku është mirëmbajtur obligimi, nga ju kërkohe të raportoni pagesat e bëra për individin në baza vjetore në një pasqyrë informatash tatimore që është dorëzuar tek autoritetet tatimore të vendit në të cilin është mirëmbajtur obligimi, dhe ai vend ka në fuqi një traktat të tatimit në të ardhura apo marrëveshje të shkëmbimit të informatave me ShBA; apo

iv. Për rastin në të cilin keni klasifikuar mbajtësin e llogarisë si person i ShBA-së në informatat e llogarisë, ju keni në posedim apo keni siguruar evidencë dokumentuese (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5)(i)(B) të Rregullores), që evidenton shtetësinë në një vend tjetër ndryshe nga ShBA.

b. Ju mund të trajtoni një entitet që ju ka ofruar Formularin W-8BEN si person i huaj nëse nuk e dini apo keni arsye të dini se entiteti është entitet rrjedhës dhe:

i. Keni në posedim ose siguruar dokumentacionin që vendos statusin e huaj që vërteton se entiteti në të vërtetë është i organizuar apo i krijuar sipas ligjeve të një shteti të huaj; apo

ii. Për një pagesë të bërë në lidhje me një obligim offshore (sikurse është përshkruar në Nenin 1.6049-5(c)(1) të Rregullores), e keni klasifikuar entitetin si rezident të vendit ku është mirëmbajtur llogaria, nga ju kërkohet të raportoni pagesat e bëra për entitetin në baza vjetore në një pasqyrë informatash tatimore që është dorëzuar tek autoritetet tatimore të vendit në të cilin është mirëmbajtur obligimi, dhe ai vend ka në fuqi një traktat të tatimit në të ardhura apo marrëveshje të shkëmbimit të informatave me ShBA;

2. Formulari është ofruar në lidhje me një obligim offshore sikurse është përshkruar në Nenin 1.6049-5(c)(1) të Rregullores dhe mbajtësi direkt i llogarisë ka ofruar udhëzime për pagesa në periudha (Standing instructions) duke ju drejtuar juve të paguani shumë nga llogaria e tij në një adresë, apo llogari e mirëmbajtur, në SHBA, përveç nëse mbajtësi i llogarisë ofron qoftë sqarim të arsyeshëm me shkrim që mbështet statusin e vetë huaj, ose evidencë dokumentuese që vendos statusin e vet të huaj (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5) (i) të Rregullores),

3. Formulari W-8BEN është ofruar nga një individ që është mbajtës direkt i llogarisë dhe është përdorë për të vendosur statusin e huaj dhe keni, ose dokumentacionin shoqëruar ose si pjesë të informatave të llogarisë, një indikacion të qartë të vendit të lindjes për individin në ShBA, përveç nëse keni në posedim apo keni siguruar evidencë dokumentuese (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5)(i)(B) të Rregullores), që evidenton shtetësinë në një vend tjetër ndryshe nga ShBA dhe ose:

a. Një kopje e Certifikatës së Humbjes së Nacionalitetit të ShBA-së nga individ, ose

b. Një sqarim i arsyeshëm me shkrim i mbajtësit të llogarisë për heqje dorë nga shtetësia e ShBA-së apo arsyen pse mbajtësi i llogarisë nuk ka siguruar shtetësinë e lindjes së ShBA-së.

4. Formulari W-8 është dorëzuar nga mbajtësi direkt i llogarisë dhe është përdorë për të vendosur rezidencën në një vend të traktatit dhe:

a. Adresa e përhershme e rezidencës në formular nuk është në vendin me traktat apo mbajtësi direkt i llogarisë ju njofton për adresën e re të përhershme të rezidencës që nuk është në vendin me traktat, përveç nëse mbajtësi direkt i llogarisë ju ofron një sqarim të arsyeshëm për adresën e përhershme të rezidencës jashtë vendit me traktat apo ju keni në posedim, apo keni siguruar, evidencë dokumentuese (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5)(i) të Rregullores), që vendos rezidencën në shtetin me traktat.

b. Adresa e përhershme e rezidencës në vendin me traktat, por adresa e postës në formular nuk është në vendin me traktat apo ju keni një adresë aktuale të postës që nuk është në vendin me traktat si pjesë e informatave tuaja të llogarisë për mbajtësin direkt të llogarisë, përveç nëse:

i. Keni në posedim, apo keni siguruar, evidencë dokumentuese (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5)(i) të Rregullores) që mbështet kërkesën e rezidencës në vendin me traktat dhe dokumentacioni shtesë nuk përmban adresë jashtë vendit me traktat;

ii. Keni në posedim, apo keni siguruar, dokumentacionin që vendos se mbajtësi direkt i llogarisë është një entitet i organizuar në një vend me traktat (apo një entitet i menaxhuar dhe i kontrolluar në një vend me traktat, nëse kërkohet nga traktati i aplikueshëm);

iii. E dini se adresa jashtë vendit me traktat (ndryshe nga kutia postare apo adresa përmes tjetër kujt) është një degë e mbajtësit direkt të llogarisë i cili është rezident i vendit me marrëveshje; apo

iv. Mbajtësi direkt i llogarisë ofron deklaratë me shkrim se në mënyrë të arsyeshme vendos të drejtën për përfitime nga traktati.

c. Mbajtësi direkt i llogarisë ju ka dhënë udhëzime për pagesa në periudha (Standing instructions) për të paguar shumë nga llogaria në një adresë apo llogari jashtë vendit me traktat përveç nëse mbajtësi i llogarisë ofron një sqarim të arsyeshëm, me shkrim, që vendos rezidencën e mbajtësit të llogarisë në një vend me traktat të aplikueshëm apo keni në posedim apo keni siguruar evidencë dokumentuese (sikurse është përshkruar në Nenin 1.1471-3(c)(5) (i) të Rregullores) që vendos rezidencën e mbajtësit të llogarisë në vendin me traktat të aplikueshëm.

Aty ku kërkohet, një sqarim i arsyeshëm që mbështet një kërkesë individuale të statusit të jashtëm nënkupton një deklaratë me shkrim të përgatitur nga individ, apo, në mënyrë alternative, një listë verifikuese të ofruar nga ju dhe e kompletuar nga individ që deklaron se individ plotëson (arrin) një prej kërkesave të listuara në nenin 1441-7(b) (12)(i) deri (iv) të Rregulloreve.

Udhëzimet për postë të mbajtur. Një adresë e dhënë nën udhëzime për të mbajtur tërë postën në atë adresë nuk është adresë e rezidencës së përhershme, të tillë sa nuk mund të mbështeteni në Formularin W-8. Megjithatë, adresa mund të përdoret si adresë e rezidencës së përhershme nëse personi ju ka ofruar evidencë dokumentuese që është e lejueshme sipas nenit 1.1441-1(c)(38)(ii) të Rregulloreve. Nëse, pas dorëzimit të Formularit W-8, adresa e rezidencës së përhershme të personit i nënshtrohet udhëzimit të postës së mbajtur, kjo është ndryshim në rrethana që kërkon nga personi të ofrojë evidencë dokumentuese të përshkruar në fjalinë paraprijëse me qëllim të përdorimit të adresës si adresë e rezidencës së përhershme.

Për informata shtesë mbi standardet e njohurive për qëllime të kapitullit 3 për t'u mbështetur në kërkesën për status të huaj apo kërkesën e rezidencës në një vend me traktat, shih nenin 1.1441-7(b) të Rregulloreve. Për informata shtesë mbi standardet e njohurive për Formularin W-8 të paraparë për qëllime të kapitullit 4, shih nenin 1.1471-3(e) të Rregulloreve.

Kërkesat e dyfishta sipas një traktati tatimor. Nëse jeni duke bërë pagesa për një entitet të huaj, i cili njëherësh kërkon shkallë të zbritur të tatimit sipas një traktati tatimor në emër të vetin dhe një kërkesë të ndarë traktati në emër të mbajtësve të saj të interesit për pagesa të ndryshme apo për pjesë të ndryshme të të njëjtave pagesa, ju mund të pranoni kërkesat e dyfishta madje edhe nëse mbani certifikata të ndryshme të mbajtjes në burim të cilat kërkojnë nga ju të trajtoni entitetin në mënyrë jo të rregullt. Përndryshe, mund të zgjidhni të aplikoni vetëm kërkesën e

bërë nga entiteti, me kusht që entiteti mund të trajtohet si pronar përfitues i të ardhurave. Megjithatë, nëse kërkesat e parregullta janë bërë për pjesën e njëjtë të pagesë, ju mund të refuzoni të dy kërkesat dhe të kërkonti kërkesa të rregullta për atë pjesë të pagesës, ose mund të zgjidhni cilën zbritje të shkallës të aplikoni.

Kërkesat për sigurimin dhe verifikimin e Numrit Identifikues Ndërmjetës Global (GIIN)

Nëse keni marrë një Formular W-8BEN, W-8IMY, apo W-8EXP nga një i paguar që është entitet e që kërkon statuse të caktuara të kapitullit 4, ju duhet të siguroni dhe verifikoni GIIN e entitetit kundrejt listës së publikuar nga IRS për FFI. Shih nenin e Rregulloreve 1.1471-3(e)(3). Ju duhet të siguroni dhe të verifikoni GIIN për statuset vijues për kapitullin 4.

- FFI pjesëmarrëse (përfshirë raportimin e FFI-ve të Modelit 2)
- FFI në përputhje të regjistruara (përfshirë raportimin e FFI-ve të Modelit 1)
- NFFE që raportojnë direkt
- NFFE e sponsorizuara që raportojnë direkt, dhe
- FFI të caktuara jo-raportuese të IGA-s (sikurse është përshkruar më poshtë)

Nëse merrni një Formular W-8BEN-E apo Formular W-8IMY nga një FFI jo-raportuese e IGA-s që është një trust i dokumentuar kujdestar që tregon se kujdestari i saj është i huaj, ju duhet të siguroni në formular një GIIN të kujdestarit.

Nëse merrni një Formular W-8 nga një FFI jo-raportuese e IGA-s që verifikon Modelin 2 IGA në Pjesën XII të Formularit W-8BEN-E, Pjesa XIX e Formularit W-8IMY, apo Pjesën III, linja 15 e Formularit W-8EXP (sipas aplikimit), dhe tregon një kategori të entitetit se është një FFI e regjistruar në përputhje sipas Aneksit II të një Modeli 2 IGA të aplikueshëm, ju duhet të siguroni dhe të verifikoni GIIN e FFI-së jo-raportuese të IGA-s kundrejt listës së FFI-ve të publikuar nga IRS. Përveç kësaj, nëse pranoni një Formular W-8BEN-E apo Formular W-8IMY nga një FFI jo-raportuese të IGA-s që ofron një citim për një nen të Rregulloreve për statusin e vet të pajtueshmërisë të regjistruar në Pjesën XII të Formularit W-8BEN-E apo Pjesën XIX të Formularit W-8IMY (sipas aplikimit) apo FFI identifikon veten si FFI e regjistruar në pajtueshmëri në Pjesën I, linja 4, të Formularit W-8EXP, ju duhet të siguroni dhe verifikoni GIIN e FFI-së jo-raportuese të IGA-s kundrejt listës së FFI-ve të publikuar nga IRS. Shih nenet 1.1471-1(b)(83) për përkufizimin e FFI-së jo-raportuese të IGA-s dhe 1.1471-3(d)(7)(i) për kërkesat e dokumentimit për FFI jo-raportuese të IGA-s, të Rregulloreve.

Për një entitet që pohon statusin e një FFI e certifikuar në pajtueshmëri se është kompani investuese sponsorizuese me numër të vogël të aksionarëve me interes kontrollues (sponsored, closely held investment vehicle) të përshkruar në nenin 1.1471-5(f)(2)(iii) të Rregulloreve në një Formular W-8BEN-E ose Formularin W-8IMY, ju duhet të merrni numrin GIIN për entitetin sponsorizues dhe ta verifikoni kundrejt listës së FFI-ve të publikuar nga IRS. Për një entitet që pohon statusin si një entitet sponsorizues i investimeve apo korporatë e huaj e

kontrolluar e përshkruar në nenin 1.1471-5(f)(1)(i)(F) të rregulloreve, ju duhet të siguroni dhe verifikoni GIIN-in e entitetit investues të sponsorizuar apo korporatës së huaj të kontrolluar kundrejt listës së FFI-ve të publikuar të IRS, e jo GIIN-in e entitetit sponsorizues.

Nëse merrni një Formular W-8BEN-E, Formular W-8IMY, apo Formular W-8EXP nga një entitet i paguar që kërkon statusin e kapitullit 4 si një FFI pjesëmarrëse (duke përfshirë një FFI raportuese të Modelit 2), FFI e regjistruar në përputhje (duke përfshirë një FFI raportuese të Modelit 1 dhe një FFI e sponsorizuar e përshkruar në rregulloret e Thesarit sipas nenin 1471), NFFE raportuese direkte, NFFE raportuese direkte e sponsorizuar, apo FFI jo-raportuese e IGA-s e kërkuar të sigurojë GIIN (sikurse është përshkruar më herët) që përmban "Aplikuar për" në kutinë për GIIN, i paguari duhet të sigurojë GIIN brenda 90 ditëve nga ofrimi i formularit. Një Formular W-8 nga një i paguar i tillë nuk përfshinë një GIIN, apo përfshirë GIIN-in që nuk shfaqet në listën e FFI-ve të publikuar nga IRS, do të mbetet e pavlefshme për qëllime të kapitullit 4 duke filluar nga data që është 90 ditë pas datës kur është dhënë formulari. Shih nenin 1.1471-3(e)(3)(iii) dhe (iv) të Rregulloreve.

Ju mund të pranoni vetëm një Formular W-8BEN-E apo Formular W-8IMY me Pjesën II të kompletuar nëse entiteti i paraqitur në Pjesën II është një FFI që është degë i entitetit të identifikuar në Pjesën II, linja 1, dhe dega është duke marrë një pagesë që mbahet në burim, apo nëse entiteti i treguar në Pjesën II është entitet i papërfillur që është identifikuar në Pjesën I, linja 3, si pranues i pagesës. Nëse merrni një Formular W-8BEN-E apo Formular W-8IMY nga një degë (ndryshe nga një degë e ShBA-së) apo nga një entitet i papërfillur të përshkruar në fjalinë e mësipërme që pranon pagesë të shoqëruar me formular, ju duhet të verifikoni GIIN-in e degës (përveç nëse dega është trajtuar si FFI jo pjesëmarrëse) apo entiteti i papërfillur që është dhënë në Pjesën II kundrejt listës së FFI-ve të pa publikuar nga IRS dhe jo ndaj atij entiteti të identifikuar në Pjesën I, linja 1. Në rast të tillë, ju mund të pranoni formularin pa GIIN në linjën 9a (për Formularin W-8BEN-E) apo linjën 9 (për Formularin W-8IMY). Nëse merrni një Formular W-8BEN-E nga një degë e ShBA-së, dega mund të ju ofrojë GIIN-in e ndonjë dege tjetër të FFI-së (përfshirë GIIN për vendin e rezidencës së FFI-së). Një degë e ShBA-së që ofron një Formular W-8IMY nuk kërkohet të ofrojë GIIN.

Rregullat e supozuara

Nëse nuk merrni një Formular W-8 apo Formular W-9 në të cilin mund të mbështeteni sipas kërkesave të kujdesit të duhur, apo ndryshe nuk mund të përcaktoni nëse pagesa duhet të trajtohet si e kryer për një person të ShBA-së apo të huaj, ju duhet të aplikoni rregullat e supozimit të parapara në Rregulloret sipas neneve 1441, 1446, 1471, 6045 dhe 6049. Nëse aplikohen rregullat e supozimit për të trajtuar një person si person i huaj, aplikohet shkalla 30% e mbajtjes në burim dhe nuk mund të ulet (për shembull, nuk ka shkallë të traktateve). Ju nuk mund të mbështeteni te rregullat e supozimit nëse keni njohuri ekzistuese se mund të aplikohet një shkallë më e lartë e mbajtjes në burim. Nëse përcaktoni se jeni duke bërë një pagesë që mbahet në burim për një entitet dhe nuk mund ta shoqërojë pagesën në mënyrë të besueshme me një

Formular W-8 apo dokumentacion tjetër të lejueshëm që është i vlefshëm për qëllimet të kapitullit 4, nga ju kërkohet të trajtoni të paguarin e entitetit si një FFI jo-pjesëmarrëse.

Kur të kërkohet Formulari i ri W-8

Kërkoni Formularin e ri W-8:

- Para skadimit të periudhës së vlefshmërisë të një Formulari W-8 ekzistues (kur aplikohet);
- Nëse formulari ekzistues nuk mbështet një kërkesë të shkallës së zbritur apo është i pakompletuar në lidhje me ndonjë kërkesë të bërë në formular (të tillë që mund të rezultojnë, për shembull, nga një kërkesë e re rregullative relevante për Formularin W-8); apo
- Nëse e dini apo keni arsye të dini për një ndryshim në rrethana që e bën ndonjë informatë në formularin e tanishëm të pabesueshëm apo të pasaktë për qëllime të kapitujve 3 ose 4 (deri në masën e aplikueshme) bazuar në kërkesat e bëra në formular.

Shembull. Një investitor i huaj individual hap një llogari me një broker për të blerë obligacione (bonds) të Thesarit të ShBA-së dhe ofron Formularin W-8BEN për të siguruar përjashtimin e interesit të portofolit. Investitori nuk plotëson Pjesën II të Formularit W-8BEN sepse ai ose ajo nuk kërkon përfitimet nga traktati. Më vonë, investitori blen aksione të ShBA-së dhe kërkon përfitimet nga traktati mbi të ardhurat në dividendë. Agjenti i mbajtjes në burim duhet të sigurojë një Formular W-8NEN të ri në kohën kur ofron informatat e kërkuara në Pjesën II për të qenë në gjendje të mbajë në burim bazuar në kërkesën nga traktati dhe jo me shkallën 30% të tatimit të mbajtur në burim.

Ndryshimi në rrethana për qëllimet të kapitullit 4.

Për qëllime të kapitullit 4, një ndryshim në rrethana në përgjithësi lind kur ka ndryshime në statusin e personit për kapitullin 4. Ju duhet të trajtoni një Formular W-8 si të pavlefshëm kur të dini apo kur keni arsye të dini për një ndryshim në rrethana që prekin saktësinë e formularit. Megjithatë, duhet të vazhdoni të trajtoni një FFI sikur të kishte statusin e kapitullit 4 që ka pasur para ndryshimit në rrethana deri në më së paku 90 ditë nga data e ndryshimit apo data kur është siguruar dokumentacioni i ri.

Nuk konsideroheni të keni arsye të dini për një ndryshim në rrethana nëse statusi i FFI-së për kapitullin 4 ka ndryshuar vetëm pse juridiksioni ku FFI është rezident, i organizuar, apo ndodhet trajtohet se ka një IGA në fuqi apo nëse juridiksioni ka pasur Modelin 2 IGA në fuqi dhe më vonë është trajtuar se ka Modelin 1 IGA në fuqi. Nëse ndryshimi i tillë në rrethana lind, FFI mund të t'u ofrojë konfirmim me gojë apo me shkrim (përfshirë e-mail) për statusin e vet të ri sipas kapitullit 4, në vend se t'u sigurojë një Formular W-8 të ri, dhe duhet të mbani një regjistrim (shënim) për këtë konfirmim.

Nëse një FFI është rezident, i organizuar, apo ndodhet në një juridiksion që trajtohet se ka një IGA në fuqi, dhe se statusi i juridiksionit në listën e IGA-s të Departamentit të Thesarit (ndodhet në www.treasury.gov/resource-center/tax-policy/treaties/pages/FATCA.aspx) më vonë është freskuar për të treguar se më nuk trajtohet se ka një

IGA në fuqi, ju do të keni arsye të dini për ndryshimin në rrethana në lidhje me statusin e FFI-së për kapitullin 4 në datën kur juridiksioni pushon së trajtuari se ka një IGA në fuqi. Shih [Announcement 2016-27](#), 2016-33 I.R.B. 238. Nëse ndryshimi i tillë në rrethana lind, FFI mundet të ju ofrojë konfirmim gojor apo me shkrim (përfshirë e-mail) për statusin e vet të ri sipas kapitullit 4, në vend se t'u sigurojë një Formular W-8 të ri, dhe duhet të mbani një regjistrim (shënim) për këtë konfirmim.

Periudha e vlefshmërisë

Përgjithësisht, një Formular W-8 është i vlefshëm nga data e nënshkrimit deri në ditën e fundit të vitit të tretë kalendarik pasues nëse ka lind ndryshimi në rrethana që i bëjnë informatat në formular të pasakta. Për shembull, një Formular W-BEN i nënshkruar më 30 shtator 2018, në përgjithësi mbetet i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2021. Megjithatë, nën kushte të caktuara një Formular W-8 do të jetë i vlefshëm pakufi po të mos ketë ndryshime në rrethana. Për shembull, një Formular W-8BEN dhe evidenca dokumentuese që mbështet kërkesën e individit për statusin e huaj (përveç pjesës së formularit ku bëhet kërkesa për përfitime traktati) janë të vlefshme pakufi nëse formulari dhe evidenca dokumentuese janë ofruar përbrenda 30 ditëve nga njëra tjetra. Një Formular W-8BEN dhe evidenca dokumentuese që mbështesin një kërkesë të entitetit për statusin e huaj (përveç pjesës së formularit ku bëhet kërkesa për përfitime traktati) që janë pranuar nga agjenti i mbajtjes në burim para periudhës së vlefshmërisë qoftë të formularit apo evidencës dokumentuese, që përndryshe do të skadonte, një formular W-8IMY është i vlefshëm pafundësisht sikurse u përshkrua në këtë paragraf, por shih më vonë [Shënimet për vërtetimin e Formularit W-8IMY](#), për periudhën e vlefshmërisë për një Formular W-8IMY të ofruar nga QDD. Për më shumë informata mbi periudhën e vlefshmërisë për Formularin W-8 për qëllime të kapitullit 3, shih nenin 1.1441-1(e)(4)(ii), të rregulloreve, si dhe për qëllime të kapitullit 4, shih nenin 1.1471-3(c)(6)(ii) të Rregulloreve.

Formularët e pranuar që nuk kanë data apo që përmbajnë gabime apo të meta të parëndësishme

Nëse një Formular W-8 është i vlefshëm përveç se personi që jep formularin nuk ka vendosur datën në formular, ju mund ta vendosni datën nga dita kur keni pranuar atë dhe matni periudhën e vlefshmërisë nga ajo datë. Në përgjithësi, ju mund të trajtoni në certifikatë të mbajtjes në burim si të vlefshme nëse përmban një gabim apo të metë që është e parëndësishme dhe ju keni dokumentacion të mjaftueshëm në dosje për të plotësuar informatat që mungojnë. Megjithatë, mos-vendosja e llojit të entitetit apo mos certifikimi i kërkuar nuk janë të parëndësishme. Për shembull, nëse një entitet merr një pagesë që mbahet në burim përzgjedh një status të certifikuar të FFI në përputhje në linjën 5 të Formularit W-8BEN-E por nuk plotëson certifikimet e kërkuara korresponduese në Pjesën V, formulari është i pavlefshëm për qëllime të kapitullit 4. Në anën tjetër, nëse pranoni formularin W-8 për të cilin personi që nënshkruan formularin nuk e shtyp (shkruan) emrin përpara nënshkrimit kur kërkohet në formular, nga ju

nuk kërkohet që të trajtoni formularin si të pakompletuar nëse keni dokumentacion apo informata që mbështesin identitetin e personit që nënshkruan formularin. Një shkurtesë për vendin e rezidencës në Formularin W-8BEN është një gabim i parëndësishëm nëse është një shkurtesë e paqartë. Për informata shtesë rreth certifikatave të mbajtjes në burim që përmbajnë gabime të parëndësishme, shih nenet 1.1441-1(b)(7)(iv) për qëllime të kapitullit 3 dhe 1.1471-3(c)(7)(i) të Rregulloreve.

Numrat e huaj Identifikues të Tatimpaguesit (TIN)

Nëse jeni zyrë apo degë e ShBA-së e një institucioni depozitues, institucioni kujdestarie, entitet investues, apo kompani specifike e sigurimit (secila sikurse është përkufizuar në nenin 1.1471-5(e) të rregulloreve që dokumenton një mbajtës të llogarisë (sikurse është përkufizuar në nenin 1.1471-5(a)(3) e Rregulloreve) të një llogarisë që është llogari financiare (sikurse është përkufizuar në nenin 1.1471-5(b) të Rregulloreve) ju duhet të siguroni TIN-in e mbajtësit të llogarisë për juridiksionin e tij të rezidencës tatimore (TIN të huaj) në një Formular W-8 që është certifikata e mbajtjes në burim e pronarit përfitues me qëllim që formulari të jetë i vlefshëm për një pagesë të të ardhurave me burim të ShBA-së që raportohen në Formularin 1042-S (sikurse është përcaktuar para aplikimit të kësaj kërkese), përveç nëse:

- Mbajtësi i llogarisë është rezident i një juridiksioni që nuk është i listuar në nenin 3 të of [Revenue Procedure 2017-46](#), 2017-43 I.R.B. 372, e cila mund të freskohet më tutje në udhëzuesin e ardhshëm të publikuar;
- Mbajtësi i llogarisë është rezident në një juridiksion që është identifikuar nga IRS në një listë të juridiksionit për të cilin agjentët e mbajtjes ën burim nuk kërkohet të sigurojnë TIN-ët;
- Mbajtësi i llogarisë është një qeveri, organizatë ndërkombëtare, bankë qendrore e huaj e emetimit, apo rezident i një territori të ShBA-së; apo
- Siguroni një sqarim të arsyeshëm pse mbajtësit të llogarisë nuk i është lëshuar TIN.

Sqarim i arsyeshëm se një mbajtësi i llogarisë nuk ka TIN të huaj duhet të adresojë pse mbajtësit të llogarisë nuk është lëshuar TIN i huaj deri në shkallën e paraparë në udhëzime për Formularin W-8 të aplikueshëm. Nëse një mbajtës i llogarisë ofron një sqarim ndryshe nga ai i përshkruar në udhëzimet për Formularin W-8 të aplikueshëm, ju duhet të përcaktoni nëse sqarimi është i arsyeshëm. Ju mund të pranoni një sqarim që është i shkruar në linjën e formularit për TIN të huaj, në margjinat e formularit, apo në një deklaram të ndarë të bashkangjitur të shoqëruar me formularin. Nëse mbajtësi i llogarisë shkruan sqarimin në linjën për TIN të huaj apo në margjinat e formularit, mbajtësi i llogarisë mund ta shkurtojë atë në "ligjrisht nuk kërkohet".

Shih [Notice 2017-46](#) për rregullat e përkohshme për agjentët e mbajtjes në burim për të siguruar TIN të huaj për llogaritë e dokumentuara ndryshe me Formularët W-8 të vlefshëm të cilët janë nënshkruar para 1 Janarit 2018. Po ashtu shih [Notice 2017-46](#) standardet e njohurive

(përfshirë edhe kur ka ndryshim në rrethana) në lidhje me kërkesat për TIN të huaj. Shih [Notice 2018-20](#) për informata shtesë mbi listën e IRS mbi juridiksionet për të cilat agjentët e mbajtjes në burim nuk kërkohet të sigurojnë TIN të huaj.

Certifikimet alternative sipas një IGA të aplikueshme

Nëse jeni FFI që i nënshtroheni Modelit 1 apo Modelit 2 IGA që përdor Formularin W-8BEN-E apo Formularin W-8IMY për të dokumentuar mbajtësit e llogarive në përputhje me kërkesat e kujdesit të duhur të Aneksit I të IGA-s së aplikueshme, mund të kërkoni certifikata alternative nga mbajtësit tuaj të llogarive në përputhje me kërkesat, si dhe përkufizimet e aplikueshme, të IGA-s në vend të certifikatave në Formularin W-8BEN-E apo Formularin W-8IMY. Ju duhet t'ia siguroni ato certifikata mbajtësve të llogarive nga të cilat ju kërkoni një Formular W-8BEN apo W-8IMY, kurse mbajtësi i llogarisë duhet t'ia bashkëngjis certifikatën e kompletuar Formularit W-8BEN-E apo W-8IMY në vend të kompletimit të certifikatës që përndryshe kërkohet. Në rastin e tillë, duhet t'ia siguroni një deklaram me shkrim mbajtësit të llogarisë duke i dëftuar se i keni dhënë certifikatë alternativë për të plotësuar kërkesat e kujdesit të duhur sipas IGA të aplikueshme dhe certifikatën duhet ta shoqëroni me Formularin W-8BEN-E apo Formularin W-8IMY .

Nëse jeni agjent i mbajtjes në burim (përfshirë FFI), ju po ashtu mund të kërkoni dhe të mbështeteni mbi një certifikatë alternative nga një mbajtës i llogarisë entitet për të vendosur se mbajtësi i llogarisë është NFFE (në vend të institucionit financiar) sipas IGA-s së aplikueshme. Një entitet që ofron një certifikatë të tillë, megjithatë, ende do t'i kërkohet të ofrojë statusin e vet të kapitullit 4 (kjo është lloji i NFFE-së) në Pjesën I, linja 5, sikurse është përcaktuar sipas rregulloreve nëse jeni agjent i mbajtjes në burim ndryshe nga një FFI që dokumenton mbajtësin e llogarisë sipas Aneksit 1 të IGA-s së aplikueshme. Për shembull, nëse jeni një agjent i mbajtjes në burim i ShBA-së që ka marrë një Formular W-8BEN-E apo W-8IMY nga një mbajtës në burim entitet që certifikon statusin e vet si NFFE pasive, ju mund të kërkoni certifikim me shkrim se entiteti nuk është institucion financiar sikurse përkufizohet me IGA të aplikueshme për entitetin dhe dokumentoni atë sipas rregulloreve duke siguruar certifikatën e NFFE-së të statusit të vet të kapitullit 4 në Pjesën I, linja 5. Megjithatë, në rast të FFI-së që dokumenton një mbajtës të llogarisë sipas Aneksit 1 të IGA-s së aplikueshme, një organizatë jo-fitimprurëse e trajtuar si NFFE sipas Aneksit mund t'i japë FFI-së një certifikatë alternative se është një NFFE që kualifikohet si organizatë jo-fitimprurëse sipas IGA-s së aplikueshme. Në rast të tillë, organizata jo-fitimprurëse nuk do të kërkohet të verifikojë në kutinë në Pjesën I, linja 5, dhe FFI mund ta trajtojë entitetin si një NFFE e përjashtuar.

Nëse merrni një certifikatë alternative sipas IGA-s së aplikueshme të përshkruar në paragrafët paraprakë, ju mund të mbështeteni në certifikimin e tillë përderisa e dini apo keni arsye ta dini se certifikimi është i saktë.

Rregullat për lloje specifike të Formularëve W-8

Formulari W-8BEN

Ju duhet të kërkonti Formularin W-8BEN nga çdo individ i huaj për qëllimet e përshkruara më herët në këto udhëzime (kjo nënkupton, nëse jeni duke kryer pagesë që i nënshtrohet kapitullit 3 të pagesës së mbajtur në burim apo që mbahet në burim; nëse jeni ortakëri që dokumenton një ortak për qëllime të nenit 1446; nëse një i paguar kërkon statusin e huaj për qëllime të informatave vendore që raporton apo mban rezervë mbajtjes në burim; apo nëse jeni FFI që përdor këtë formular për të dokumentuar një llogari për qëllime të kapitullit 4).

Shënimet për vërtetimin e Formularit W-8BEN

Linja 6 (TIN i huaj). Nëse nuk merrni TIN të huaj (apo një sqarim të arsyeshëm pse mbajtësit të llogarisë nuk i është lëshuar një TIN i huaj) në linjën 6 (apo në një deklaratë të ndarë) kur kërkohet (shih më herët [Numrat e huaj Identifikues të Tatimpaguesit \(TIN\)](#)), ju duhet ta trajtoni formularin si të pavlefshëm për pagesat e të ardhurave me burim ShBA të raportueshme në Formularin 1042-S (sikurse është përcaktuar përpara aplikimit të kësaj kërkesë).

Linja 6 (Data e lindjes). Nëse jeni zyrë apo degë e ShBA-së e një institucioni depozitues, institucioni kujdestarie, entiteti investues, apo kompanie specifike e sigurimeve (secila sikurse është përkufizuar në nenin 1.1471-5(e) të Rregulloreve) që dokumenton një mbajtës individual të llogarisë (sikurse është përkufizuar në nenin 1.1471-5(a)(3) të Rregulloreve) për një llogari që është llogari financiare (sikurse është përkufizuar në nenin 1.1471-5(b) të Rregulloreve), ju duhet të siguronit datën e lindjes së mbajtësit individual të llogarisë në Formularin W-8BEN me qëllim që formulari të mos jetë i pavlefshëm për një pagesë të të ardhurave me burim ShBA-të të raportueshme në Formularin 1042-S (sikurse është përcaktuar përpara aplikimit të kësaj kërkesë). Nëse data e lindjes së individit nuk është dhënë në Formularin W-8BEN, formulari nuk është i pavlefshëm nëse ndryshe keni datën e lindjes në dosjen e llogarisë për mbajtësin e llogarisë apo merrni datën e lindjes në një deklaratë me shkrim (duke përfshirë një deklaratë me shkrim të transmetuar me email) nga mbajtësi i llogarisë dhe deklaratën me shkrim e shoqëroni me Formularin W-8BEN. Shih [Notice 2017-46](#) për rregullat e transmetimit për agjentët e mbajtjes në burim për të siguruar datat e lindjes për llogaritë e dokumentuara ndryshe me Formularët W-8 të vlefshëm që janë nënshkruar para 1 janarit 2018.

Linja 10 (Shkallët dhe kushtet speciale). Nëse pronari përfitues kërkohet të sqarojë kushte shtesë në traktat që plotëson të drejtën për shkallë të mbajtjes në burim në linjën 10, ju duhet të merrni një sqarim të shkurt për këtë qëllim. Ju mund të merrni një kërkesë traktati pa këtë sqarim sipas një neni të interesit apo dividendëve (ndryshe nga dividendët që i nënshtrohen një shkalle të preferuese bazuar në pronësi) të traktatit apo neni tjetër i të ardhurave, përveç nëse neni i tillë kërkon përfaqësim shtesë.

Formulari W-BEN-E

Duhet të kërkonti Formularin W-8BEN nga çdo entitet i huaj për qëllimet e përshkruara më herët në këto udhëzime për Formularin W-8BEN apo nëse i paguari do të vendos se të ardhura të caktuara nga kontrata parimore joreale nuk janë të lidhura në mënyrë efektive me kryerjen e një tregtie apo biznesi të ShBA-së (për raportim në Formularin 1042-S). Shih 1.1441-4 nenin të Rregulloreve.

Shënimet për vërtetimin e Formularit W-BEN-E

Pjesa I, Linja 4 (Statusi i Kapitullit 3). Nëse pranoni një Formular W-8BEN-E nga një entitet që tregon në Pjesën I, linja 4, se është entitet i papërfillur, ortakëri, trust i thjeshtë, apo trust i granteve (grantor trust), si dhe entiteti ka verifikuar me "Jo" në Pjesën I, linja 4 (lidhur me kërkesën e entitetit për përfitimet nga traktati), ju duhet të mos e pranoni Formularin W-8BEN-E nëse formulari është përdorë në lidhje me shumat e raportueshme apo pagesat që mbahen në burim. Në raste të tilla, duhet të kërkonti nga entiteti të plotësojë një Formular W-8IMY nëse entiteti është ortakëri, trust i thjeshtë, apo trust i granteve, ose kërkonti nga pronari i entitetit të papërfillur të plotësojë Formularin W-8 të duhur. Nëse jeni FFI që dokumenton një mbajtës të llogarisë entitet vetëm për qëllime të kapitullit 4 (kjo do të thotë, se nuk ju kërkohet të dokumentoni të paguarin për qëllime të mbajtjes në burim apo raportim të informatave vendore), entiteti nuk ka nevojë të japë statusin e kapitullit 3 në linjën 4 të formularit.

Pjesa I, Linja 9b (TIN i huaj). Nëse nuk siguronit një TIN të huaj (apo sqarim të arsyeshëm pse mbajtësit të llogarisë nuk i është lëshuar një TIN i huaj) në linjën 9b (apo një deklaratë të ndarë) kur kërkohet (shih më herët [Numrat e huaj Identifikues të Tatimpaguesit \(TIN\)](#)), ju duhet ta trajtoni formularin si të pavlefshëm për pagesat e të ardhurave me burim ShBA që raportohen në Formularin 1042-S (sikurse është përcaktuar më parë aplikimi i kësaj kërkesë).

Pjesa II (Entitet i Papërfillur apo Degë që pranon pagesa). Nëse jeni duke bërë pagesa për degë të shumta/entitete të papërfillshme që do të plotësonin Pjesën II, si dhe Pjesën I të informatave për secilën degë/entiteti i papërfillur është i njëjtë, në vend se të sigurohet Formulari W-8BEN-E i ndarë në lidhje me secilën degë/entiteti i papërfillur, ju mund të pranoni një Formular W-8BEN-E të vetëm me një tabelë të bashkëngjitur e të ndarë që përfshinë të gjitha informatat që kërkohen nga Pjesa II për secilën degë/entiteti i papërfillur dhe jeni në gjendje të përcaktoni secilën pagesë për secilën degë/entitet të papërfillur që shoqërohet me formularin. Shih më herët [Kërkesat për sigurimin dhe verifikimin e Numrit Identifikues Ndërmjetës Global \(GIIN\)](#), kur kërkohet një GIIN kur të jetë plotësuar Pjesa II.

Pjesa III (Kërkesa për Përfitimet nga Traktati Tatimor), Linja 14b. Për një Formular W-8BEN-E të siguruar më apo pas 1 janarit 2017, një entitet që kërkon shkallë të zbritur të mbajtjes në burim sipas një traktati të tatimit në të ardhura që përmban një kufizim në nenin e përfitimeve duhet të identifikohen kufizimet në dispozitën e përfitimeve që plotësohet duke verifikuar një prej kutive në linjën 14(b). Në përgjithësi, entiteti kërkohet vetëm të verifikojë

një kuti, madje edhe nëse plotëson më shumë se një dispozitë. Nëse traktati i aplikueshëm nuk ka kufizime në nenin e përfitimeve, entiteti duhet të verifikojë (shënojë) kutinë për "Tjera" dhe të vendos "N/A" (nuk aplikohet) në linjën e dhënë. Ju mund të mbështeteni në kërkesën e entitetit në linjën 14(b) përveç nëse keni njohuri aktuale se kërkesa është e pasaktë.

Pjesa III, Linja 15 (Shkallët speciale dhe kushtet).

Nëse pronari përfitues kërkohet të sqarojë kushte shtesë në traktat se plotëson të drejtën për shkallë të mbajtjes në burim në linjën 15, ju mund të pranoni një sqarim të shkurtër. Ju mund të pranoni një kërkesë traktati pa këtë sqarim sipas një neni të interesit apo dividendëve (ndryshe nga dividendët që i nënshtrohen një shkalle të preferuese bazuar në pronësi) të traktatit apo neni tjetër të të ardhurave, përveç nëse neni i tillë kërkon përfaqësime shtesë.

Pjesa IX, Linja 24 (FFI me Pronar të Dokumentuar). Ju mund të pranoni këtë certifikatë dhe ta trajtoni një entitet si një FFI me pronar të dokumentuar vetëm nëse ju jeni një agjent i caktuar i mbajtjes në burim sipas rregulloreve të kapitullit 4. Po ashtu, një FFI me pronar të dokumentuar që është një FFI jo-raportuese për IGA duhet të vërtetojë (shënojë) "FFI me pronar të dokumentuar" (dhe jo FFI jo-raportuese për IGA) në linjën 5 dhe të plotësojë Pjesën X. Ju duhet të pranoni një Formular W-8BEN-E nga një entitet i cili kërkon statusin si FFI me pronar të dokumentuar që nuk verifikon kutinë 24 në Pjesën X pavarësisht se a e dini se entiteti është trust që ka një apo më shumë përfitues të mundshëm.

Formulari W-8ECI

Ju duhet të kërkonti Formularin W-8ECI nga çdo person apo organizatë e huaj për të cilën ju kryeni pagesa sikur të ishte pronar përfitues i të ardhurave (apo një entitet i angazhuar në një tregti apo biznes të ShBA-vë që dorëzon formularin në emër të pronarëve, ortakëve apo përfituesve të vet) dhe pohon se të ardhurat në mënyrë efektive janë të lidhura me kryerjen e tregtisë apo biznesit në SHBA. Megjithatë, nëse jeni ortakëri, ju duhet të kërkonti një Formular W-BEN ose W-8BEN-E (sipas aplikimit) nga një ortak i huaj se janë të ardhura të alokuara që në mënyrë efektive janë të lidhura me kryerjen e tregtisë apo biznesit të ortakërisë në ShBA. Prapëseparapë, një ortak i huaj që ka bërë një përzgjedhje sipas nenit 871(d) apo nenit 882(d) duhet t'ia japë atë përzgjedhje ortakërisë së bashku me një Formular W-8ECI.

Nëse merrni një Formular W-8ECI pa TIN të ShBA-së të vendosur në linjën 7, ju mund të mos i trajtoni të ardhurat si të lidhura në mënyrë efektive me tregtinë apo biznesin në ShBA dhe duhet të aplikoni rregullat e duhura të supozimit. Nëse merrni një Formular W-8ECI pa TIN të huaj (apo një sqarim të arsyeshëm pse mbajtësit të llogarisë nuk i është lëshuar një TIN i huaj) në linjën 8 (apo në një deklaram të ndarë) kur kërkohet (shih më herët *Numrat e huaj Identifikues të Tatimpaguesit (TIN)*), ju duhet ta trajtoni formularin si të pavlefshëm për pagesat e të ardhurave të ShBA-së që raportohen në Formularin 1042-S (sikurse është përcaktuar përpara aplikimit të kësaj kërkesë).

Pranimi i juaj i Formularit W-8ECI shërben si një

përfaqësim nga i paguari apo pronari përfitues se zërat e të ardhurave të identifikuar në linjën 11 janë në mënyrë efektive të lidhura me kryerjen e tregtisë apo biznesit brenda SHBA-së. Kështu, nëse një pronar përfitues ju jep një Formular W-8ECI, ju duhet të trajtoni të gjitha të ardhurat me burim të ShBA-së të identifikuar në linjën 11 të paguara për atë pronar përfitues sikur të jenë të lidhura në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit përbrenda ShBA-së e jo si pagesë që mbahet në burim për qëllime të kapitullit 4. Në përputhje me rrethanat, statusi i kapitullit 4 nuk kërkon që i paguari të dorëzojë një Formular W-8ECI të vlefshëm përveç nëse jeni FFI që kërkon një Formular W-8ECI nga një mbajtës i llogarisë për qëllime të kërkesave të kujdesit të duhur të kapitullit 4.

Nëse paguani zëra të të ardhurave që nuk janë të identifikuar në linjën 11 nga pronari përfitues si të lidhura në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit përbrenda ShBA-së, në përgjithësi nga ju kërkohet të siguronit edhe një lloj tjetër të Formularit W-8 nga pronari përfitues.

Në përgjithësi, ju mund të mos e trajtoni një shumë si e ardhur e lidhur në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit përbrenda SHBA-së përveç nëse pronari përfitues ju jep një Formular W-8ECI të vlefshëm. Megjithatë, ka përjashtime (të përshkruara më poshtë) për të ardhurat e paguara në kontratat parimore joreale dhe pagesat e bëra për degë të caktuara të ShBA-së.

Kontratat parimore joreale që raportohen në Formularin 1042-S. Mbajtja në burim në shkallën 30% nuk kërkohet në shumën e paguara sipas kushteve të një kontrate parimore joreale pavarësisht se a është dorëzuar një Formular W-8ECI (përveç kur një pagesë e bërë sipas kontratës së tillë është e ardhura me burim ShBA, të tillë si shumë ekuivalente me dividend sipas nenit 871(m)). Sidoqoftë, nëse të ardhurat janë të lidhura në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit në ShBA, janë të raportueshme nga ju në Formularin 1042-S (pavarësisht se pagesa a është e ardhur me burim të SHBA-së apo jo). Ju duhet t'i trajtoni të ardhurat si të lidhura në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit në ShBA, madje edhe nëse nuk është marrë një Formular W-8ECI, nëse të ardhurat e paguara për një njësi biznesi të kualifikuar të një personi të huaj më vendndodhje në ShBA apo nëse të ardhurat janë paguar për një njësi biznesi të kualifikuar për një person të huaj me vendndodhje jashtë ShBA-së dhe ju e dini, apo keni arsye ta dini, se pagesa është e lidhur në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit të SHBA-së. Sidoqoftë, një pagesë nuk trajtohet si e ardhur e lidhur në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit në ShBA nëse i paguari jep një Formular W-8BEN-E që parqet se pagesa nuk është e ardhur e lidhur në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit në ShBA apo bën një paraqitje në një marrëveshje kryesore që drejton transaksionet në kontratat parimore joreale në mes të palëve (për shembull, një Marrëveshje Ndërkombëtare e Këmbimeve dhe Derivateve) apo në konfirmimin në transaksionin e veçantë të kontratës parimore joreale, se i paguari është një person i ShBA-së apo një degë jo-ShBA e një personi të huaj.

Pagesat për degë të caktuara të ShBA-së të trajtuara si të ardhura në lidhura në mënyrë efektive. Nëse bëni një pagesë për një degë të ShBA-së të një banke të huaj apo kompanie të sigurimit që nuk ofron certifikatë të mbajtjes në burim por ka ofruar një Numër Identifikues të Punëdhënësit (Employer Identification Number – EIN), pagesa supozohet të jetë e lidhur në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit në ShBA, madje edhe nëse personi i huaj (apo dega e tij e SHBA-së) nuk iu jep një Formular W-8ECI. Nëse nuk siguron një Formular W-8ECI apo EIN të degës së ShBA-së, të ardhurat e paguara nuk mund të trajtohen se janë të lidhura në mënyrë efektive me kryerjen e tregtisë apo biznesit në ShBA.

Formulari W-8EXP

Ju duhet të kërkonte Formularin W-8EXP nga një qeveri e huaj, organizatë ndërkombëtare, bankë qendrore e huaj e emetimeve, organizatë e huaj e liruar nga tatimi, fondacion i huaj privat, apo qeveri e një territori të ShBA-së për të cilën ju kryeni pagesë të një shume që i nënshtrohet mbajtjes në burim sipas kapitullit 3 nëse personi i tillë kërkon një përjashtim nga mbajtja në burim sipas neneve 1441, 1442, dhe 1443 në përputhje me nenin 115(2), 501(c), 892, apo 895, apo kërkon një shkallë të mbajtjes në burim sipas nenit 1443(b). Përveç nga ajo që është ofruar më poshtë, ju duhet të kërkonte Formularin W-8EXP nga një person i cili kërkon një përjashtim nga mbajtja në burim sipas kapitullit 4 si një pronar përfitues apo organizatë e liruar nga tatimi sipas nenit 501(c) apo që kërkon ndonjë status tjetër të kapitullit 4 të treguar në formular kur po ashtu kërkon një status të kapitullit 3 të përshkruar në fjalinë paraprake. Në rast të caktuar, mund të kërkohej një GIIN bazuar në statusin e kapitullit 4 të kërkuar në formular. Shih më herët, *Kërkesat për sigurimin dhe verifikimin e Numrit Identifikues Ndërmjetës Global (GIIN).*

Nëse jeni FFI që dokumenton një mbajtës të llogarisë që është organizatë e liruar nga tatimi apo pronar përfitues i përjashtuar (secili sikurse është përshkruar për qëllime të kapitullit 4) për të cilët ju nuk paguani shuma që i nënshtrohen mbajtjes në burim sipas kapitullit 3, ju mund të kërkonte që mbajtësi i llogarisë të plotësojë Formularin W-8BEN-E (në vend të Formularit W-8EXP) për të vendosur statusin e vet për qëllime të kapitullit 4.

Një Formular W-8EXP i dorëzuar nga një person i huaj që është ortak në një ortakëri për qëllime të mbajtjes në burim sipas neneve 1441 deri 1443 gjithashtu do të themelojë (vendos) atë status të huaj të ortakut për qëllime të nenit 1446. Megjithatë, përveç nga ajo që është paraparë në nenin 1.1446-3(c)(3) të rregulloreve (lidhur me organizata të caktuara të liruara nga tatimi të përshkruara në nenin 501(c)), dorëzimi i Formularit W-8EXP nuk do të ketë efekt nëse ortaku i nënshtrohet mbajtjes në burim apo jo sipas nenit 1446.

Ju mund ta trajtoni të paguarin si një organizatë ndërkombëtare pa kërkuar një Formular W-8EXP nëse i paguari është i caktuar si një organizatë ndërkombëtare nga një urdhër ekzekutiv (në përputhje me 22 U.S.C. 288 deri 288(f) dhe fakte tjera që lidhen me pagesën që në mënyrë të arsyeshme tregojnë se pronari përfitues i pagesës është një organizatë ndërkombëtare. Në lidhje

me shumat e dala nga pranimet e bankave për qëllime të kapitullit 3, ju mund ta trajtoni të paguarin si bankë qendrore të emetimeve pa kërkuar Formularin W-8EXP nëse emri i të paguarit dhe faktet tjera që lidhen me pagesën në mënyrë të arsyeshme tregojnë se pronari përfitues i pagesës është një bankë qendrore e huaj e emetimeve.

Një TIN i ShBA-vë kërkohej nëse pronari përfitues kërkon një lirim apo shkallë të zbritur të mbajtjes në burim duke u bazuar vetëm në një kërkesë për status të kapitullit 3 sipas nenit 501(c) apo status të fondacionit privat. Megjithatë, një TIN i ShBA-së nuk kërkohej nga një fondacion i huaj privat që i nënshtrohet akcizës tatimore prej 4% në të ardhurat bruto të investimeve (sipas nenit 4948(a)) që do të ishte i liruar nga mbajtja në burim përveç për nenin 4948(a) (për shembull, interesi i protofolit).

Nëse pranoni një Formular W-8EXP pa një TIN të huaj (apo një sqarim të arsyeshëm se pse mbajtësit të llogarisë nuk i është lëshuar TIN) në linjën 8b (apo në një deklaram të ndarë) kur kërkohej (shih më herët, *Numrat e huaj Identifikues të Tatimpaguesit (TIN)*), ju duhet ta trajtoni formularin si të pavlefshëm për pagesat e të ardhurave me burim ShBA që raportohen në Formularin 1042-S (sikurse është përcaktuar para aplikimit të kësaj kërkesë).

Formulari E-IMY

Ju duhet të kërkonte Formularin W-8IMY nga çdo entitet që është ndërmjetës i kualifikuar (qualified intermediary-QI) (përfshirë një QI që vepron si diler i kualifikuar derivativ (qualified derivative dealers=QDD), ndërmjetës të pakualifikuar (përfshirë degë të caktuara të ShBA-së dhe institucione financiare territoriale), një ortakëri e huaj e mbajtjes në burim (WP), një trust i huaj i mbajtjes në burim (WT), apo një entitet rrjedhës për të cilën bëni një pagesë që mbahet në burim apo paguani një shumë të raportueshme. Një entitet rrjedhës përfshinë një ortakëri të huaj (ndryshe nga një WP), një trust të huaj të thjeshtë apo trust i granteve (ndryshe nga një WT), si dhe, për çdo pagesë për të cilën është kërkuar një përfitim nga traktati, çdo entitet deri në shkallën sa trajtohet si transparent në mënyrë fiskale sipas ligjeve të juridiksionit në traktat, sikurse është paraparë në nenin 894 dhe rregullave nën të (pavarësisht a është transparent në mënyrë fiskale sipas ligjeve të ShBA-ve). Para 1 Janarit 2020, Formulari W-8IMY mundet po ashtu të dorëzohet nga një entitet për të kërkuar statusin e kapitullit 3 si huadhënësi i kualifikuar i letrave me vlerë (qualified securities lender - QSL) në lidhje me pagesat e dividendëve zëvendësuese me burim të ShBA-së dhe mund të mbështetet në to pavarësisht se QSL a vepron si një ndërmjetës në lidhje me dividendët zëvendësues e shoqëruar me formularin. Ju mund të pranoni një Formular W-8IMY nga një individ i cili vepron si një agjent apo ndërmjetës (i ndryshuar si duhet për t'u llogaritur si me status individual), por nga ju nuk kërkohej të siguron një formular të tillë nëse jeni në gjendje t'i shoqëroni pagesat e kryera me personin(at) për të cilët individët veprojnë.

Ju mund të pranoni Formularë W-8IMY të shumëfishtë nga një ndërmjetës që vepron në kapacitete të shumëfishta (për shembull, si një Ndërmjetës i Kualifikuar për një llogari por një ndërmjetës i pakualifikuar apo QDD për një llogari tjetër). Megjithatë, një Ndërmjetës i

Kualifikuar mund të ju ofrojë një Formular W-8IMY të vetëm që mbulon më shumë se një kategori të ndërmjetësve të kualifikuar të treguar në formularin e dhënë që në mënyrë të duhur ju identifikon llogaritë dhe/ose transaksionet në një deklaratë të mbajtjes në burim. Ju mund të pranoni një Formular W-8IMY të vetëm për degë të shumëfishta të entitetit që ju jep formularin nëse informatat në Pjesën I janë të njëjta për secilën degë dhe të jetë bashkangjitur një tabelë e darë që përfshinë të gjitha informatat e Pjesës II në secilën degë dhe informatat të mjaftueshme për të lidhur pagesat me secilën degë.

Statusi i kapitullit 4 i një ndërmjetësi apo entiteti rrjedhës kërkohet në Pjesën I të formularit nëse formulari është i shoqëruar me një pagesë që mbahet në burim. Pjesa II duhet të kompletohet kur një pagesë që mbahet në burim është kryer për një degë apo entitet të papërfillur të përshkruar në Pjesën II të formularit.

Në përgjithësi, për qëllimet e të dy kapitujve 3 dhe 4, përveç deri sa ndryshe të jetë paraparë në Rregulloret sipas neneve 1441 apo 1471, një Formular W-8IMY duhet të shoqërohet me një deklaratë të mbajtjes në burim dhe certifikatat e mbajtjes në burim (apo evidencë dokumentuese, ku lejohet) për pronarët përfitues. Në përgjithësi, deklarata e mbajtjes në burim duhet të alokojë (caktojë) pagesën për secilin të paguar (apo grupin e të paguarve, ku lejohet, sikurse është përshkruar më vonë), të japë shkallën e mbajtjes në burim për secilin të paguar (apo grup të të paguarve), si dhe të japë informatat të caktuara identifikuese mbi secilin të paguar që nuk është i përfshirë në një grup. Shih nenin 1.1441-1(e)(3)(iv)(C)(3) të Rregulloreve për lejimin e agjentit të mbajtjes në burim të pranojë një deklaratë alternative të mbajtjes në burim nga një ndërmjetës i pakualifikuar (e cila po ashtu aplikohet në një entitet rrjedhës).

Nëse jeni një FFI pjesëmarrëse apo FFI që konsiderohet e harmonizuar, mundeni po ashtu të kërkonin Formularin W-8IMY nga një ndërmjetës apo entitet rrjedhës që është një mbajtës i llogarisë për të vendosur statusin e vet të kapitullit 4 apo statusin nën një IGA të aplikueshme madje edhe kur nuk ka pagesa që i nënshtrohen mbajtjes në burim apo raportime për informatat vendore që janë bërë për llogarinë. Në rast të tillë, nuk kërkohet një deklaratë e mbajtjes në burim.

Shënimet për vërtetimin e Formularit W-8IMY

QI-të, WP-të dhe WT-të (në përgjithësi). Një QI, WP, apo WT që vepron në kapacitetin e vet si e tillë duhet të ofrojë Numrin Identifikues të Entitetit -EIN që i është lëshuar entitetit në kapacitetin e tillë (kjo është QI-EIN, WP-EIN, apo WT-EIN) në Formularin W-8IMY dhe jo ndonjë EIN tjetër që mund ta ketë në kapacitetin e ndërmjetësit të pakualifikuar, ortakërisë së huaj që nuk mban në burim, apo trust i huaj që nuk mban në burim. Për arsye se statusi si QI,WP, apo WT për një institucion financiar është i kufizuar në klasa të caktuara të FFI-ve, nëse jeni duke bërë pagesë që mbahet në burim për një QI,WP, apo WT që është institucion financiar, duhet të verifikoi se QI,WP, apo WT certifikon statusin e vet si një prej klasave të lejuara në nenet e 1.1441-1(e)(5) (ii) (për QI), 1.1441-5(c)(2)(ii) (për WP), apo 1.1441-5(e) (5)(v)

(për WT) të Rregulloreve dhe jep GIIN e vet (përveç në rast të bankave qendrore të huaja të emetimeve dhe fondeve të pensionimit).

Nëse një QI shënon në linjën 15b të Pjesës III të formularit për të certifikuar se merr Formularin 1099 primar të raportimit dhe përgjegjësinë e mbajtjes së rezervës në burim, ju mund të pranoni formularin edhe nëse nuk e dini nëse ka ndonjë llogari të ShBA-së që merr pagesa të raportueshme në kohën e certifikimit. Nëse një QI nuk shënon (vërteton) në linjën 15b apo 15c të Pjesës III të formularit, ju duhet të konfirmoni se QI nuk është duke pranuar pagesa për llogaritë e ShBA-vë të cilat janë të raportueshme në Formularin 1099, dhe se QI duhet të ju dorëzojë një deklaratë të mbajtjes në burim nëse pagesat ia alokon (cakton) llogarive të tilla për të cilat nuk merr përgjegjësinë primare të mbajtjes në burim. Një QI mund të shënojë në linjën 15e të Pjesës III të formularit për të treguar se e cakton një pjesë të pagesës sipas kapitullit 4 për shkallën e mbajtjes në burim në grupin e të paguarve të ShBA-së që përfshinë mbajtësit e llogarive të një ndërmjetësi tjetër apo një entiteti rrjedhës madje edhe nëse deklarata e mbajtjes në burim nuk tregon ndonjë ndërmjetës apo entitet rrjedhës në kohën kur është dhënë certifikimi. Megjithatë, një QI nuk kërkohet të shënojë (verifikojë) linjën 15e të Pjesës III të formularit deri sa të ofrojë deklaratën e mbajtjes në burim duke identifikuar një ndërmjetës apo entitet rrjedhës që pranon pagesë të caktuar për një grup të shkallës së mbajtjes në burim për kapitullin 4 të të paguarit të ShBA-së.

QI-të të vepronjë si QDD. Ju duhet vetëm të pranoni një Formular W-8IMY nga një QI që vepron si QDD deri në shkallën sa bëni pagesa në lidhje me transaksionet e mundshme sipas nenin 871(m) apo letrat themelore me vlerë për QDD kur entiteti kërkon statusin e QDD-së në Pjesën III të formularit. Një QDD duhet të tregojë klasifikimin e vet të entitetit në linjën 16b të formularit. Nëse jeni duke bërë pagesa të tilla, që është një shumë që i nënshtrohet mbajtjes në burim sipas kapitullit 3, për një QI që vepron si një QDD dhe QDD kërkon përfitime nga traktati i aplikueshëm për statusin e identifikuar në linjën 16b në pagesë, ju mund ta trajtoni Formularin W-8IMY si një certifikatë të mbajtjes në burim të pronarit përfitues dhe t'i jepni përfitimet e tilla nëse QDD jep një deklaratë të shoqëruar me Formularin W-8IMY që përfshinë informatat e nevojshme në lidhje me kërkesën e traktatit të kërkuar në Pjesën III të Formularit W-8IMY. Në rast të tillë, pjesa e certifikatës që bën kërkesën për përfitimet nga traktati është e vlefshme deri në fund të vitit të tretë kalendarik që pason vitin në të cilin Formulari W-8IMY është nënshkruar (përveç nëse më herët dalin ndryshime në rrethana), si dhe aplikohen rregulla të verifikimit për një kërkesë traktati. Një QDD mundet në vend të saj të ofrojë një Formular W-8BEN-E të ndarë për të bërë kërkesë traktati. Përndryshe ju mund ta trajtoni një Formular W-8IMY të dorëzuar në një QDD (ndryshe nga një entitet rrjedhës apo entitet i papërfillur) si një certifikatë e mbajtjes në burim të pronarit përfitues për të vendosur (përcaktuar) statusin e huaj të QDD-së për një pagesë të të ardhurave FDAP me burim të ShBA-së (për aq sa QDD të japë TIN e huaj të vet (kur kërkohet) në një deklaratë të mbajtjes në burim të QDD apo një deklaratë të ndarë). Një QDD që pranon pagesa të

cilat janë në pronësi përfutuese e të cilat nuk janë të mbuluara nga marrëveshja e vetë e QI-së, duhet të dorëzojë Formularin W-8 të duhur bazuar në statusin e vet (dhe jo Formularin W-8IMY). QDD duhet t'u japë një deklaratë të mbajtjes në burim për të identifikuar zyrën kryesore apo degën që është trajtuar si pronar për qëllime të tatimit në të ardhura të ShBA-së dhe, në rrethana të caktuara (të përshkruara në udhëzimet për formularin W-8IMY), TIN i huaj i QDD (apo një sqarim i arsyeshëm se pse i është lëshuar TIN i huaj, nëse kërkohet). Pavarësisht fjalisë paraprake, nga ju nuk kërkohet të siguroni deklaratë të mbajtjes në burim të QDD-së nëse dega apo zyra kryesore e QDD-së është identifikuar në formular dhe formulari është dërguar vetëm për pagesa që janë pronësi përfutuese nga QDD (dhe një TIN i huaj është dhënë kur është kërkuar). Shih më herët Numrat e huaj Identifikues të Tatimpaguesit (TIN), se kur duhet të trajtoni formularin si të vlefshëm nëse një TIN i huaj apo sqarim i arsyeshëm nuk është dhënë.

QI-të që marrin mbajtjen në burim në pagesat e interesit zëvendësues. Nëse një QI paraqet statusin e vet si një QI në një Formular W-8IMY në lidhje me pagesat e interesit dhe interesit zëvendësues dhe shënimet vërtetuese në linjën 15g të Pjesës III të formularit, ju mund ta trajtoni QI-në si marrëse të mbajtjes në burim për pagesat e interesit dhe interesit zëvendësues që i pranon nga ju në lidhje me një shitje-riblerje, apo kolateral që QI e mban në lidhje me aktivitetet e veta si diler në letrat me vlerë.

QSL-të. Nëse bëni pagesë të një dividendi zëvendësues me burim të ShBA-së për një QSL (para 1 janarit 2020), QSL kërkohet të ofrojë TIN e vet të ShBA-së. Nëse bëni pagesë për një QSL (para 1 janarit 2020) ajo është pagesë për mbajtje në burim, ju duhet të mblidhni një Formular W-8IMY që përfshinë statusin e kapitullit 4 të QSL-së dhe GIIN (nëse aplikohet) për të shmangur mbajtjen në burim sipas kapitullit 4. Një QSL që është QI duhet të shënoj/vërtetoj në linjën 15f të Pjesës III të formularit dhe një QSL që është një ndërmjetës i pakualifikuar duhet të shënoj/verifikoj në linjën 17d të Pjesës IV të formularit. Ju mund të mos shoqëroni një Formular W-8IMY nga një QSL me një pagesë të një dividendi zëvendësues në ose pas 1 janarit 2020, dhe duhet të siguroni një certifikatë të ndryshuar të mbajtjes në burim.

Për informata mbi rregullat kalimtare për vitin 2018 dhe 2019 për agjentët e mbajtjes në burim për t'i aplikuar në lidhje me QSL-të, shih Notice 2018-05.

Degët e ShBA-së. Nëse bëni pagesë për një degë të SHBA-së të një banke apo kompanie sigurimesh të huaj që paraqet se vepron si një ndërmjetës dhe është pajtuar të trajtohet si person i ShBA-së, nga ju nuk kërkohet të siguroni GIIN apo statusin e kapitullit 4 të entitetit, por duhet të siguroni EIN të degës së ShBA-së. Nëse bëni pagesë që mbahet në burim pas 30 qershorit 2017, për një degë të ShBA-së të një FFI që vepron si një ndërmjetës dhe nuk pajtohet të trajtohet si person i SHBA-së, dega duhet të ofrojë EIN e vet (por nuk duhet të sigurojë GIIN apo status të kapitullit 4) dhe të verifikojë se dega është duke aplikuar rregullat e përshkruara në nenin 1.1471-4(d)(2)(iii)(C) të Rregulloreve duke

shënuar/vërtetuar në kutinë në linjën 19 në Pjesën VI të formularit. Nëse nuk e siguroni certifikatën nga dega e ShBA-së të përshkruar në fjalinë e mëparshme, ju duhet të trajtoni degën si një FFI jo-pjesëmarrëse dhe të mbani në burim sipas kapitullit 4 mbi pagesat që mbahet në burim të bëra për degën. Nga ju nuk kërkohet të trajtoni si të pavlefshëm një Formular W-8IMY nga një mbajtës i llogarisë që plotëson Pjesën VI të formularit (deri sa kërkohet) por nuk plotëson Pjesën II të formularit.

Institucionet financiare territoriale që veprojnë si ndërmjetës. Nëse bëni pagesë për një institucion financiar territorial që vepron si ndërmjetës, ju duhet të siguroni EIN të institucionit financiar territorial nëse pajtohet të trajtohet si person i ShBA-së për kapitujt 3 dhe 4. Nga ju nuk kërkohet të siguroni GIIN për një institucion financiar territorial.

FFI pjesëmarrëse dhe FFI e regjistruar në përputhje që nuk janë entitete rrjedhëse apo veprojnë si ndërmjetës. Nëse një FFI pjesëmarrëse dhe FFI e regjistruar në përputhje që është një ndërmjetës apo entitet rrjedhës ju jep një deklaratë të mbajtjes në burim dhe dokumentacionin për mbajtësit e vet të llogarive apo të paguarit, nga ju nuk kërkohet të verifikoni informatat mbi mbajtësit e llogarive apo të paguarve të dhënë në dokumentacion për qëllime të kapitullit 4 përveç nëse informatat në dokumentacion janë dukshëm të pasakta, e nga ju nuk kërkohet të siguroni dokumentacion shtesë për një mbajtës të llogarisë apo të paguar përveç për certifikatën e mbajtjes në burim veç nëse duke siguruar dokumentacionin për qëllime të kapitullit 3 apo 62, apo veç nëse e dini se rishikimi i dokumentacionit i kryer nga FFI pjesëmarrëse apo FFI e regjistruar në përputhje nuk ka qenë i duhur për qëllime të kapitullit 4. Shih nenin 1.1441-7(b)(10) të Rregulloreve për kërkesat e kujdesit të duhur për mbajtësit indirekt të llogarive për qëllime të kapitullit 3 dhe shih nenin 1.1471-3(e)(4)(vi)(B) të Rregulloreve për standardet që aplikohen në rast të tillë për të përcaktuar nëse aplikohet kapitulli 4 për mbajtje në burim. Ju mund të mbështeteni në dokumentacionin që nuk përfshinë një status të kapitullit 4 për një mbajtës të llogarisë të një ndërmjetësi apo entiteti rrjedhës që është një FFI kur deklarata e mbajtjes në burim e dhënë nga entiteti i tillë tregon se pagesa është bërë për një llogari të përjashtuar si llogari financiare sipas nenin 1.1471-5(b)(2). të Rregulloreve.

Një ndërmjetës apo entitet rrjedhës që është një FFI pjesëmarrëse apo FFI e regjistruar në pajtim mund të jap një status për qëllime të kapitullit 4 i gjetur sipas kërkesave (dhe dokumentacioni apo informatat që janë publikisht në dispozicion e të cilat përcaktojnë statusin e kapitullit 4 të të paguarit të lejuar sipas) të një IGA të aplikueshme për një mbajtës të llogarisë, me kusht që të keni informatat e nevojshme për të raportuar në Formularin 1042-S. Përveç kësaj, shih më herët Certifikimi alternativ sipas një IGA të aplikueshme, për detaje të mëtejshme mbi certifikimet alternative.

Në përgjithësi, nëse bëni pagesa që mbahen në burim për një ndërmjetës apo entitet rrjedhës që është një FFI pjesëmarrëse apo FFI e regjistruar në pajtim, FFI mund të ofrojë një deklaratë të mbajtjes në burim të FFI-së që përcakton (alokon) një pjesë të pagesës për grupin e shkallës (normës) të mbajtjes në burim të kapitullit 4. Nëse

një ndërmjetës me Formularin e vet W-8IMY ofron deklaratën e mbajtjes në burim të FFI-së që alokon një pjesë të pagesës për një grup të shkallës së mbajtjes në burim të kapitullit 4 të të paguarve të ShBA-së, FFI duhet të ofroj një status të kapitullit 4 në linjën 5. Nëse ndërmjetësi i përshkruar në fjalinë e mëparshme është një ndërmjetës i pakualifikuar, duhet të jap certifikatën e kërkuar në Pjesën IV në lidhje me përmbushjen e kërkesave të nenin 1.6049-4(c)(4) të Rregulloreve (apo kërkesa të ngjashme sipas kapitullit 61 për një pagesë ndryshe nga interesi). Nëse ndërmjetësi është një QI, duhet të vërtetojë (certifikojë) se i plotëson kërkesat e nenit 1.6049-4(c)(4)(iii) të Rregulloreve, për aq sa të paguarit e ShBA-së janë mbajtës të llogarive të një ndërmjetësi apo entiteti rrjedhës që pranon pagesë nga QI, dhe QI ka siguruar apo do të sigurojë dokumentacionin e mjaftueshëm për të vendosur për secilin status të tillë të ndërmjetësit apo entitetit rrjedhës si një FFI pjesëmarrëse, FFI e regjistruar në pajtim, apo FFI që është një QI. Një alokim i një pagese i treguar në një deklaratë të mbajtjes në burim dhe e bërë më ose pas 1 Prillit 2017, për një ndërmjetës të pakualifikuar, ortakëri e huaj që nuk mban në burim, apo trust i huaj që nuk mban në burim një shumë që i nënshtrohet mbajtjes në burim të kapitullit 3 për një grup të shkallës së mbajtjes në burim të kapitullit 4 të të paguarve të ShBA-së, duhet të identifikojë të paguarit në përputhje me përshkrimin në nenin 1.1471-3(c)(3)(iii)(B)(2)(iii) të Rregulloreve (përshkrimi i mbajtësve të llogarive të një FFI-je që është pagues jo-ShBA që nuk i nënshtrohen mbajtjes në burim sipas kapitullit 3 dhe 4 apo sipas nenit 3406, si dhe të cilët janë mbajtës të llogarive të ShBA-së të raportuar nga FFI sipas kërkesave të veta të FATCA-s si një FFI pjesëmarrëse apo FFI e regjistruar në pajtim).

Kërkesat e nenit 1446. Ju duhet të kërkonti Formularin W-8IMY për qëllime të nenit 1446 vetëm nga një ortakëri e huaj e nivelit të lartë (foreign upper-tier partnership) apo trust i huaj i granteve. Përgjithësisht, për qëllime të nenit 1446, Formulari W-8IMY i dorëzuar nga këto entitete është përdorë të transmetojë formularët e pronarëve të këtyre entiteteve. Formularët tjerë duhet të shoqërohen me informatat e nevojshme për t'i shoqëruar në mënyrë të besueshme zërat e ortakërisë të lidhura në mënyrë të efektshme me ortakët e nivelit të lartë, dhe grant-dhënësin apo pronar tjetër, në rastin e një trusti të huaj të granteve. Mandej, duhet të shikoni përmes këtyre entiteteve pronarët përfitues kur përcaktohet obligimi tatimor i juaj sipas nenit 1446. Një ortakëri vendore e nivelit të lartë mundet po ashtu të ju ofrojë këtë informatë. Sipas këtyre rrethanave ju mundeni, por nuk kërkohet ta bëni, të paguani tatimin e mbajtur në burim sipas nenit 1446 të ortakëve të huaj të ortakërisë vendore të nivelit të lartë. Shih nenin 1.1446-5 të Rregulloreve.

Kërkesat për Entitetet Hibride dhe Hibride të Kthyeshme.

Një entitet hibrid është një entitet që trajtohet si transparent në mënyrë fiskale sipas Kodit por nuk trajtohet transparent në mënyrë fiskale sipas ligjeve tatimore të një vendi me të cilin ShBA ka traktat për tatimin në të ardhura.

Nëse jeni duke bërë pagesë për një entitet hibrid të

huaj që është duke bërë kërkesë për përfitime nga traktati në emër të vetin, entiteti hibrid duhet të dorëzojë një Formular W-8BEN-E me kërkesën për përfitime nga traktati. Nëse entiteti hibrid është një entitet rrjedhës (e jo entiteti i papërfillur) që kërkon përfitimet nga traktati në emër të vetin në një pagesë që është pagesë që mbahet në burim, duhet po ashtu të ju japë një Formular W-8IMY (duke përfshirë edhe statusin e vet të kapitullit 4) së bashku me deklaratën e mbajtjes në burim (nëse kërkohet) që vendos (përcakton) statusin e kapitullit 4 për secilin nga ortakët apo pronarët e vet për të përcaktuar nëse mbajtja në burim aplikohet për çdo pjesë të pagesës.

Informatat e alokimit nuk kërkohen në këtë deklaratë të mbajtjes në burim vetëm nëse një a më shumë ortakë apo pronarë i nënshtrohen mbajtjes në burim të kapitullit 4. Nëse entiteti hibrid është entiteti i papërfillur që kërkon përfitimet nga traktati në një pagesë që është pagesë që mbahet në burim, përveç nëse entiteti i papërfillur është trajtuar si i paguar për qëllime të kapitullit 4 dhe ka GIIN të vet, pronari i vetëm duhet të ju dorëzojë një Formular W-8BEN-E ose Formularin W-8BEN (nëse aplikohet) së bashku me Formularin W-8BEN-E për entitetin hibrid. Linja 10 e Formularit W-8BEN mund të përdoret nga entiteti hibrid për të shoqëruar Formularët W-8.

Një entitet i huaj hibrid kthyes është një entitet që është një korporatë për qëllime tatimore të SHBA-së por transparent në mënyrë fiskale sipas ligjeve tatimore të një vendi me të cilin ShBA ka traktat të tatimit në të ardhura. Nëse një entitet i huaj hibrid kthyes pranon pagesë për të cilën entiteti kërkon një shkallë të zbritur të mbajtjes në burim për pronarët e vet, ju duhet të siguroni nga entiteti Formularin W-8IMY (duke përfshirë statusin e tij të kapitullit 4 nëse pagesa është një pagesë që mbahet në burim) së bashku me deklaratën e mbajtjes në burim dhe dokumentacionin për pronarin për të cilin entiteti kërkon përfitimet nga traktati. Nëse entiteti i huaj hibrid kthyes pranon pagesë që mbahet në burim dhe nuk kërkon përfitimet nga traktati në emër të ndonjë pronari të vet, ju duhet të siguroni vetëm një Formular W-8BEN-E nga entiteti për të vendosur statusin e tij të kapitullit.

Formularët W-8 zëvendësues për pagesat e shumave të raportueshme dhe pagesat që mbahen në burim

Ju mund të zhvilloni dhe të përdorni Formularin W-8 tuajin (formular zëvendësues) për qëllime të kapitullit 3 dhe 4 nëse përmbajtja e tij është në thelb e ngjashme me formularin W-8 zyrtar të IRS-it (për aq sa kërkohet nga këto institucione), plotëson kërkesa të caktuara të certifikimit, dhe përmban një nënshkrim nën ndëshkimet për deklarim të rremë që është identike me atë të cekur në formularin zyrtar. Ju mund të zhvilloni dhe të përdorni një formular zëvendësues që është në një gjuhë të huaj me kusht që të bëni përkthimin në anglisht të formularit dhe përmbajtjes së tij dhe të jetë në dispozicion për IRS kur kërkohet. Ju mund t'i kombinoni Formularët e shumë W-8 në një formular të vetëm zëvendësues.

Një formular që plotëson ato kërkesa të formularëve zëvendësues mund të trajtohet si një formular i pajtuar i ngjashëm për qëllime të një IGA të aplikueshme përveç nëse partneri i juridiksioni nuk e pranon trajtimin e tillë.

Një formular zëvendësues nuk është e nevojshme të përmbajë të gjitha dispozitat e përmbajtura në formularin zyrtar, për aq sa përmban ato dispozita që janë relevante për transaksionin për të cilin është ofruar. Ju mund të hiqni certifikimet për kapitullin 4 në formularin tuaj zëvendësues nëse certifikatat e tilla nuk kërkohen bazuar në pagesat e bëra për të paguarit. Nëse jeni një FFI që dokumenton statusin e kapitullit 4 të mbajtësve tuaj të llogarive sipas kërkesave të kapitullit 4 apo IGA të aplikueshme megjithatë, ju nuk mund të hiqni certifikimet e kapitullit 4. Nëse bëni pagesa që mbahen në burim, ju mund të zgjidhni të jepni formularin zëvendësues që nuk i përmban të gjitha statuset e kapitullit 4 të parapara në Formularin W-8, por formulari zëvendësues duhet të përmbajë çdo status të kapitullit 4 për të cilën mund të aplikohet mbajtja në burim.

Ju mund të inkorporoni një formular zëvendësues W-8 në formularët tjerë të punës që zakonisht i përdorni, të tillë si kartelat nënshkruese të llogarisë, me kusht që certifikatat e kërkuara të jenë qartë të përcaktuara. Sidoqoftë, ju nuk mund:

1. Të përdorni formular zëvendësues që kërkon nga i paguari, duke nënshkruar, të pajtohet në dispozitat që nuk lidhen me certifikatat e kërkuara; apo

2. Të lihet të kuptohet se një person mund t'i nënshtrohet 30% mbajtjes në burim apo mbajtjes në burim rezervë përveç nëse ai person pajtohet me dispozitat mbi formularin zëvendësues që nuk lidhen me certifikimet e kërkuara.

Një Formular W-8 zëvendësues është i vlefshëm vetëm nëse përmban ndëshkimet e njëjta për deklarim dhe certifikime të rreme sikurse formularët zyrtarë dhe nënshkrimin e kërkuar. Megjithatë, nëse formulari zëvendësues përmbahet në disa forma tjera të punës, fjalët "informatat në këtë formular" mund të ndryshohen për t'iu referuar asaj pjese të formularit të punës që përmban informatat e formularit zëvendësues. Dizajni i formularit zëvendësues duhet të jetë i tillë që informatat dhe certifikimet që vërtetohen (dëshmohen) nën ndëshkimet për deklarim të rremë qartë të dallohen nga çdo informatë tjetër që përmbahet në formular.

Përmbajtja e formularit zëvendësues

Formulari zëvendësues W-8BEN. Formulari zëvendësues W-8BEN duhet të përmbajë të gjitha informatat e kërkuara në Pjesën I, linjat 1 deri 8. Certifikimet në Pjesën II duhet të përfshihen në një formular zëvendësues vetëm nëse kërkohen përfitimet nga traktati, dhe mandej deri në masën sa kërkohen certifikimet. Për shembull, Formulari W-8BEN, linja 10 (shkallët dhe kushtet e veçanta), nuk kërkohet nëse formulari është kërkuar nga një individ i cili pranon pagesë nga dividendët me burim ShBA-në nga aksionet që janë shitur në mënyrë aktive në një treg të themeluar të letrave me vlerë. Formulari zëvendësues W-8BEN duhet të përfshijë një deklarim që nëse peroni i cili jep formularin është rezident në një juridiksion partner FATCA (e kjo është, juridiksion i Modelit 1 IGA me reciprocitetet), informata të caktuara të llogarisë tatimore mund t'i jepen juridiksionit të rezidencës.

Formulari zëvendësues duhet të përmbajë ndëshkimet për deklarim të rremë identike me deklarimin

në Formularin zyrtar W-8BEN. Përveç kësaj, nëse formulari zëvendësues është i inkorporuar në formularët tjerë të punës, duhet të prezantohet deklarimi vijues në të njëjtën mënyrë sikurse ndëshkimet për deklarim të rremë dhe duhet të duket menjëherë mbi linjën e vetme të nënshkrimit: "Shërbimi i të Hyrave të Brendshme (IRS) nuk e kërkon pëlqimin tuaj në asnjë dispozitë të këtij dokumenti përveç certifikimeve që kërkohen për të vendosur (përcaktuar) statusin tuaj si individ jo-ShBA dhe, nëse aplikohet, siguro shkallën e zbritur të mbajtjes në burim".

Formulari zëvendësues W-8BEN-E. Formulari zëvendësues W-8BEN-E duhet të përmbajë të gjitha informatat e kërkuara në Pjesën I, linjat 1 deri 6, si dhe linjat 8 dhe 9 nëse kërkohet TIN i huaj apo GIIN. Sidoqoftë shih më herët, *Formularët W-8 zëvendësues për pagesat e shumave të raportueshme dhe pagesat që mbahen në burim*, se kur mund ta hiqni certifikimin për kapitullin 4 në një Formular zëvendësues W-8. Certifikimet në Pjesën II duhet të përfshihen në formularin zëvendësues nëse jeni duke bërë një pagesë që mbahet në burim për një entitet të papërfillur apo një degë që duhet të raportohet në Pjesën II. Certifikimet në Pjesën III duhet të përfshihen vetëm nëse kërkohen përfitimet nga traktati, dhe mandej vetëm deri në shkallën sa kërkohen certifikimet. Shih më herët, *Certifikimet alternative sipas një IGA të aplikueshme*, në këto udhëzime, për rrethanat në të cilat mund të zëvendësohen certifikimet e kapitullit 4 me certifikime alternative.

Nëse formulari zëvendësues është inkorporuar në formularët tjerë të punës, duhet të prezantohet deklarimi vijues në të njëjtën mënyrë sikurse ndëshkimet për deklarim të rremë dhe duhet të duket menjëherë mbi linjën e vetme të nënshkrimit: "Shërbimi i të Hyrave të Brendshme (IRS) nuk e kërkon pëlqimin tuaj në asnjë dispozitë të këtij dokumenti përveç certifikimeve që kërkohen për të vendosur (përcaktuar) statusin tuaj si individ jo-ShBA dhe, nëse aplikohet, siguro shkallën e zbritur të mbajtjes në burim".

Formulari zëvendësues W-8ECI. Formulari zëvendësues W-8ECI duhet të përmbajë të gjitha informatat e kërkuara në Pjesën I, përveç linjës 9. Certifikimet në Pjesën II të Formularit W-8ECI duhet të përfshihen në një formular zëvendësues.

Nëse formulari zëvendësues është inkorporuar në formularët tjerë të punës, duhet të prezantohet deklarimi vijues në të njëjtën mënyrë sikurse ndëshkimet për deklarim të rremë dhe duhet të duket menjëherë mbi linjën e vetme të nënshkrimit: "Shërbimi i të Hyrave të Brendshme (IRS) nuk e kërkon pëlqimin tuaj në asnjë dispozitë të këtij dokumenti përveç certifikimeve që kërkohen për të vendosur (përcaktuar) statusin tuaj si individ jo-ShBA dhe se të hyrat për të cilat është dhënë ky formular është në mënyrë efektive i lidhur me kryerjen e tregtisë apo biznesit përbrenda ShBA-ve".

Formulari zëvendësues W-8EXP. Formulari zëvendësues W-8EXP duhet të përmbajë të gjitha informatat e kërkuara në Pjesën I, linjat 1 deri 5, linja 7 (nëse kërkohet TIN i ShBA-ve), dhe linja 8. Sidoqoftë shih më herët, *Formularët W-8 zëvendësues për pagesat e shumave të raportueshme dhe pagesat që mbahen në burim*, se kur mund ta hiqni certifikimin për kapitullin 4 në

një Formular zëvendësues W-8. Formulari zëvendësues W-8BEXP duhet të përmbajë të gjitha deklaratimet dhe certifikimet të përmbajtura në Pjesët II dhe III, sipas aplikimit, në lidhje me qëllimin për të cilin formulari është dhënë, por duhet të përfshihet një deklaram apo certifikimi i veçantë (në tërësinë e tij) vetëm nëse është relevant me llojin e entitetit që jep formularin. Për shembull, nëse një agjent i mbajtjes në burim dokumenton një pronar përfitues, e që është qeveri e huaj për qëllime të të dy kapitujve 3 dhe 4, agjenti i mbajtjes në burim mundet të përdor Formularin zëvendësues W-8EXP që përmban informatat e nevojshme në Pjesën I, plus deklaratimet dhe certifikimet e kërkuara nga Pjesa II dhe III që lidhen me qeveritë e huaja, dhe nuk duhet të përfshijë deklaratimet dhe certifikimet për llojet tjera të entiteteve që përndryshe do të dorëzonin Formularin W-8EXP.

Nëse formulari zëvendësues është inkorporuar në formularët tjerë të punës, duhet të prezantohet deklarimi vijues në të njëjtën mënyrë sikurse ndëshkimet për deklaram të rremë dhe duhet të duket menjëherë mbi linjën e vetme të nënshkrimit: “Shërbimi i të Hyrave të Brendshme (IRS) nuk e kërkon pëlqimin tuaj në asnjë dispozitë të këtij dokumenti përveç certifikimeve që kërkohen për të vendosur (përcaktuar) statusin tuaj si qeveri e huaj, organizatë ndërkombëtare, bankë qendrore e huaj e emetimit, organizatë e huaj e liruar nga tatimi, fondacion i huaj privat, apo qeveri në posedim të ShBA-vë, si dhe statusin e kapitullit 4 (nëse kërkohet)”.

Formulari zëvendësues W-8IMY. Formulari zëvendësues W-8IMY duhet të përmbajë të gjitha informatat e kërkuara në Pjesën I, linjat 1 deri 6, linja 8 (nëse kërkohet TIN i ShBA-ve), dhe linja 9. Sidoqoftë shih më herët, *Formularët W-8 zëvendësues për pagesat e shumave të raportueshme dhe pagesat që mbahen në burim*, se kur mund ta hiqni certifikimin për kapitullin 4 në një Formular zëvendësues W-8. Informatat e kërkuara në Pjesën II duhet të përfshihen në një formular zëvendësues nëse jeni duke bërë pagesë që mbahet në burim për një entitet të papërfillshëm që ka GIIN apo degë të vetën (duke përfshirë një degë që është entitet i papërfillur që nuk ka GIIN të vetin) e që operon në një juridiksion ndryshe nga juridiksioni i rezidencës së entitetit të emëruar në Pjesën I të formularit. Formulari zëvendësues W-8IMY duhet po ashtu të përmbajë të gjitha deklaratimet dhe certifikimet që lidhen me kapitullin 3 të përmbajtur në Pjesët III deri VIII nëse jeni duke bërë një pagesë që i nënshtrohet mbajtjes në burim sipas kapitullit 3 dhe deklaratimet dhe certifikimet që lidhen me statusin e kapitullit 4 që përmbahet në Pjesët IX deri XXVIII për entitetin ndërmjetës apo entitetin rrjedhës që jep formularin nëse jeni duke bërë pagesë që mbahet në burim apo nëse jeni FFI që dokumentoni mbajtësit tuaj të llogarive për qëllime të kapitullit 4 apo një IGA të aplikueshme. Për shembull, nëse vetëm ndërmjetësit për të cilët agjenti i ShBA-së i mbajtjes në burim kryen pagesa janë ndërmjetës të kualifikuar që janë FFI pjesëmarrëse, agjenti i mbajtjes në burim mund të përdor një Formular zëvendësues W-8IMY që përmban vetëm informatat e kërkuara nga Pjesa I (duke përfshirë linjën 9 për të mbledhur GIIN-ët e ndërmjetësve), plus deklaratimet dhe certifikimet nga Pjesa III. Një Formular zëvendësues W-8IMY po ashtu duhet të inkorporojë bashkëngjitjet e

njëta si formulari zyrtar (të tilla si deklarimi i mbajtjes në burim dhe dokumentimi i pronarit përfitues, deri kur kërkohet ndryshe). Ju po ashtu mund të përfshini çdo informatë në Formularin zëvendësues W-8IMY, apo të kërkoni çdo informatë që duhet të shoqërohet me formularin, që është në mënyrë të arsyeshme e lidhur me obligimin tuaj për të mbajtur në burim dhe për të raportuar saktë pagesat.

Nëse formulari zëvendësues është inkorporuar në formularët tjerë të punës, duhet të prezantohet deklarimi vijues në të njëjtën mënyrë sikurse ndëshkimet për deklaram të rremë dhe duhet të duket menjëherë mbi linjën e vetme të nënshkrimit: “Shërbimi i të Hyrave të Brendshme (IRS) nuk e kërkon pëlqimin tuaj në asnjë dispozitë të këtij dokumenti përveç certifikimeve që kërkohen për të vendosur (përcaktuar): (1) statusin tuaj si ndërmjetës i kualifikuar, ndërmjetës i pakualifikuar, lloji i veçantë i degës së ShBA-së, partneritet i huaj i mbajtjes në burim, trust i huaj i mbajtjes në burim, partneritet i huaj i mos-mbajtjes në burim, trust i thjeshtë i huaj i mos-mbajtjes në burim, apo trust grant-dhënës i huaj i mos-mbajtjes në burim; (2) statusin tuaj të kapitullit 4; dhe/ose (3) para 1 Janarit 2020, statusin tuaj si një dhënës i kualifikuar i letrave me vlerë.”

Formulari që nuk është i IRS për individët që nuk marrin shuma të raportueshme

Nëse jeni FFI që dokumentoni mbajtësin e llogarisë që është individ dhe ju nuk bëni pagesa të shumës së raportueshme për atë mbajtës të llogarisë, ju mund të përdorni formularin që nuk është i IRS-it në vend të një formulari zëvendësues W-8BEN. Formulari duhet të përfshijë emrin dhe adresën e individit që është paguar apo pronar përfitues, të gjitha vendet në të cilat individit është rezident për qëllime tatimore, vendin e lidhjes së individit, numrin identifikues të tatimpaguesit, nëse ka, për secilin vend të rezidencës, si dhe datën e lindjes së individit. Formulari po ashtu mundet të kërkojë informata tjera që kërkohen për qëllime të tatimeve apo kundër pastrimit të parave (anti-money laundering - AML) nga kujdesi i duhur në ShBA apo në vendet tjera. Një formular që plotëson këto kërkesa mund të trajtohet si një formular i ngjashëm i pajtuar për qëllime të një IGA të aplikueshme përveç nëse juridiksioni partner e mohon një trajtim të tillë.

Në përgjithësi, një formular që nuk është IRS për individët duhet të përmbajë certifikimin e nënshkrimit dhe datën të bërë nën ndëshkimet për deklaram të rremë se informatat e dhëna në formular janë të sakta dhe do të freskohen nga individ brenda 30 ditëve nga një ndryshim në rrethana që shkakton pasaktësi në formular. Megjithatë, certifikimi i nënshkruar i dhënë në formular duhet të nënshkruhet nën ndëshkimet për deklaram të rremë nëse formulari është shoqëruar me evidencë të dokumentueshme që mbështesin kërkesën e individit për status të huaj. Evidenca e tillë dokumentuese mund të jetë e njëjtë që është përdorë për të mbështetur statusin e huaj në rastin e një të paguari llogaria e të cilit ka indikacione të ShBA-së sikurse është përshkruar në nenet 1.1471-3(e) dhe 1.1471-4(c)(4)(i)(A) të Rregulloreve.

